

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5681
E hënë, 21 janar 2019
çmimi 0.40 €

Auditimi i ndërmarrjes 'Trepça', i domosdoshëm

FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

Prononсим në dokumentarin me rastin e 1 vjetorit të ndarjes nga jeta!
Kushtuar jetës dhe veprës së Liderit të Luginës së Preshevës
Jonuz Musliu

**JONUZ MUSLIU, NJË JETË
LUFTË PËR ATDHE F. 12**



Ismet SYLEJMANI

**SHQIPTARËT
KURRË NUK
KANË CENUAR
INTERESA TË
MIQVE E AS
TË ARMIQVE F. 12**



Jakup KRASNIQI

**SBASHK-U: GREVA VAZHDON.
MOS NA BËNI PRESION F. 7**

**VESELI PRET NË TAKIM
"REMIN": UÇK-JA LUFTOI NË
ANËN E DREJTËSISË F. 3**

EKONOMI

**REKORDE TË
ARRITURA SI
ASNJËHERË MË
PARË NË
HISTORINË E
TERMOCENTRALEVE
TË KEK-UT F. 12**



Njazi THAÇI

KULTURË

**'LAMTUMIRË
BACA ADEM',
LIBËR PËR
DHIMBJEN TONË
KRENARE F. 6**



Lulëzim ETEMAJ

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI | FAQE 4-5

Pezullimi i taksës, i domosdoshëm

- Po rrezikohen marrëdhëniet me ShBA-në



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Kosova duhet t'i trajtojë seriozisht kërkesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për pezullimin e taksës ndaj Serbisë. Ai ka theksuar se Amerika po sugjeron pezullimin e taksës por,

në rast se dialogu do të dështonte, taksë do të vazhdonte me automatizëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka thënë se pezullimi i taksës është i domosdoshëm meqë po i rrezikon marrëdhëniet e Kosovës me

aleaten kryesore, ShBA-në. Ai ka thënë se mund të vihet në pikëpyetje edhe ndihma për mbështetjen e ushtrisë së Kosovës. Sipas Maliqit, mesazhet e Uashingtonit janë kërcënime serioze dhe nuk duhet të neglizhohen

Thaçi: E kemi mbështetjen e ShBA-së dhe të BE-së për marrëveshjen me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se tani është shansi më i mirë për marrëveshjen historike Kosovë - Serbi. Thaçi, i cili ka kërkuar heqjen e taksës për mallrat serbe, ka deklaruar se një marrëveshje e tillë ka mbështetjen e BE-së dhe të ShBA-së. Mirëpo opozita dhe një pjesë e pozitës e kanë kritikuar qasjen e presidentit ndaj dialogut me Serbinë | FAQE 3



**Vazhdon
mungesa e
transparencës
në uebfaqet
e partive
politike | FAQE 6**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Protesta kundër presidentit serb në Beograd

BEOGRAD, 20 JANAR - Mijëra veta parakaluan rrugëve të Beogradit në protestat kundër, siç thuhet, sundimit autokratik të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Protesta e së shtunës pasoi tubimin e partisë së presidentit Vuçiq të enjten gjatë vizitës së presidentit rus Vladimir Putin në Beograd. Kritikët e presidentit Vuçiq thonë se ai e organizoi tubimin në një përpjekje për të

dysuar se ka më shumë mbështetës sesa kundërshtarët e tij në Serbi. Duke brohoritur, "Vuçiq, largohu", turma parakaloi para selisë së televizionit publik, i cili ka injoruar në masë të madhe protestat disajavëshe. Kritikët e akuzojnë presidentin Vuçiq për vendosje të autokracisë nëpërmjet kontrollimit të rreptë të medias dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes ndaj kundërshtarëve. Ai i

ka hedhur poshtë këto akuzë. Protestuesit kërkuar liri të medias si parakusht për zgjedhje të lira e të drejta. Protestat me sloganin "Një nga pesë milionë", filluan shtatë javë më parë me moton "Stop këmbishëve të përgjakura", kur ndodhi një sulm mbi Borislav Stefanoviçin, udhëheqës i partisë së vogël "E Majta serbe". Ai ishte sulmuar nga një grup burrash me



maska të zeza më 23 nëntor në Krushevc, një qytet në jug të

Serbisë dhe kishte pësuar plagë të lehta.

Opozita maqedonase përpiqet ta pengojë zbatimin e Ligjit të gjuhës shqipe

Faktorë dhe individë maqedonas, me qëndrime nacionaliste, po përpiqen ta pengojnë zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve që para pak ditësh u botua në Gazetën Zyrtare, duke hyrë kështu në fuqi, e që i lejon një shtrirje të gjerë gjuhës shqipe

SHKUP, 20 JANAR - Opozita maqedonase dhe faktorë të tjerë maqedonas po përpiqen ta pengojnë zbatimin e Ligjit të gjuhës shqipe duke ngritur padi kundër personave dhe organeve që e vunë në fuqi atë dhe me nisma për vlerësimin e ligjit nga Gjykata Kushtetuese. Qeveria thotë se maqedonishtja është gjuhë e vetme zyrtare në të gjithë territorin e vendit dhe se me anë të ligjit do t'i jepet fund nacionalizmit në vend.

Faktorë dhe individë maqedonas me qëndrime nacionaliste po përpiqen ta pengojnë zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve

që para pak ditësh u botua në Gazetën Zyrtare, duke hyrë kështu në fuqi, e që i lejon një shtrirje të gjerë gjuhës shqipe.

Partia opozitare VMRO-DPMNE ka paraqitur padi në gjykatë kundër kryetarit të parlamentit, Talat Xhaferi dhe sekretarit teknik të parlamentit e drejtorit të Gazetës Zyrtare, sepse ligji u botua pa nënshkrimin e presidentit Gjorgje Ivanov, "një akt ky kundërkushtetues", sipas VMRO-së. Partia paralajmëron edhe ankimin para Gjykatës Kushtetuese për ligjin. Ndërkohë, këtë tashmë e ka bërë një ish-ekspert i VMRO-së, Jove



Kekenovski, i cili në opinionin publik të këtushëm njihet si analist politik. "Gjykata Kushtetuese duhet ta ketë parasysh edhe faktin se ligji nuk u nënshkrua nga presidenti i Maqedonisë", thotë Kekenovski duke vërejtur se ligji qe miratuar me 69 vota dhe jo me dy të tretat në parlamentin prej 120 vendesh.

Ndërkohë, Qeveria e Maqedonisë përmes një komunikate thekson se gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik mbetet gjuha e vetme zyrtare në të gjithë territorin e vendit dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, ndërsa "Ligji i gjuhëve i avancoi të drejtat e të gjitha komuniteteve joshumicë". Nuk do të ketë

punësime të reja për ta zbatuar ligjin, bën të ditur qeveria, duke i hedhur poshtë spekulimet e opozitës maqedonase për shpenzime shtesë të buxhetit.

Agjencia për zbatimin e Ligjit të gjuhëve që do të themelohet do të pajiset me burime njerëzore nga ministritë, agjencitë dhe sekretariatet ekzistuese. Qeveria thekson se me Ligjin e përdorimit të gjuhëve i jep fund nacionalizmit, ndërsa avancoi të drejtat dhe nevojat e çdo qytetari të të gjitha komuniteteve.

Nga ana tjetër, partitë politike shqiptare thonë se shqipja do të jetë gjuhë e dytë zyrtare në të gjithë Maqedoninë. Në të vërtetë, ligji i ri lejon përdorimin e gjuhës së një komuniteti që përbën më tepër se 20 për qind në pothuaj se të gjitha pushtetet, që nga ai qendror, gjyqësor e deri tek ai lokal, por jo në ushtri; shqipja nuk do të figurojë as në bankënotat e këtij vendi.

Kryemadhi: Në qershor ka revolucion, do ta zbythim Edi Ramën



TIRANË, 20 JANAR - Mundësia për realizimin e zgjedhjeve parlamentare së bashku me zgjedhjet lokale të 30 qershorit është theksuar sërish sot në një takim me strukturat e LSI-së në Skrapar, nga Monika Kryemadhi. Kryetarja e partisë së dytë më të madhe në opozitë ripërsëriti nga qyteti ku lindi e u rrit bashkëshorti i saj Ilir Meta, kërkesën për një revolucion qytetar, me synimin për ta rrëzuar nga posti kryeministrin

Edi Rama, të cilit i renditi një listë të gjatë skandalesh. "Kemi një datë të dekretuar për zgjedhje lokale, por ajo datë nuk do të jetë vetëm për zgjedhje lokale, do të jetë dhe për zgjedhje të përgjithshme, pasi shqiptarët nuk mund të qeverisen nga një qeveri e korruptuar, e cila ka grabitur mandatet në parlament dhe i ka të blera", tha kryetarja e LSI-së.

Duke theksuar se sfida e shqiptarëve është ta rrëzojnë Ramën,

Kryemadhi bëri me dije se nga Brukseli "po dëgjojmë një rrufe në qiell të hapur". "Dëgjojmë se si komisionari Hahn shprehet se Rama ka mbajtur peng reformat. Kudo që shkel, dëgjoj se edhe socialistë të ndershëm që janë të mërëzitur me Rilindjen. Kur nuk ka socialist të ndershëm që suporton këtë njeri, tani duhet thënë se kushtet janë pjekur. Do të dalim në rrugë dhe do ta rrëzojmë Edi Ramën", deklaroi Kryemadhi.

PD-ja zgjedh Kryesinë e re

TIRANË, 20 JANAR - Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike zgjodhi Kryesinë e re të kësaj force politike, më të vogël në numër, nga mbi 50 në 15, e ku bien në sy emra të njohur të selisë blu, si Oerd Bylykbashi, Jorida Tabaku, Florian Mima dhe Enkelejd Alibeaj. Tërheq gjithashtu

vëmendjen edhe emri i Tomorr Alizotit, i njohur si kritik i Bashës, i cili kishte dhënë dorëheqje nga funksionet pas përplasjes me kryetarin. Për shkak të respektimit të detyrimit statutor të 30% të kuotave gjinore, kanë hyrë në Kryesinë e demokratëve deputetët Dhurata

Çupi, Grida Duma, Oriola Pampuri dhe Izmira Ulqinaku, ndonëse nuk kishin arritur të merrnin votat e mjaftueshme. Atokanë spostuar nga lista, duke i nxjerrë jashtë Kryesisë, disa kolegë meshkujsh, të cilët gjithsesi i kishin manë votat e mjaftueshme. Bëhet

fjalë për Ervin Salianjin, i cili mbetet një deputet i thjeshtë, jashtë Kryesisë dhe jashtë Sekretariatit. Të njëjtin fat me të patën edhe deputetët Aldo Bumçi e Luçiano Boçi, si dhe Gert Bogdani e Roland Bejko.

Gjatë votimit për kryesinë e

demokratëve nuk kanë rezultuar fitues deputetët Rudina Hajdari, Genc Pollo, Gent Strazimiri, Klevis Balliu dhe Fatbardh Spahiu. Ndërkohë që PD-ja respektoi kuotat gjinore për Kryesinë e partisë, në Sekretariatit e rinukka asnjë femër të zgjedhur.

Kosova vazhdon të mos flasë me një zë për dialogun me Serbinë

Thaçi: E kemi mbështetjen e ShBA-së dhe të BE-së për marrëveshjen me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se tani është shansi më i mirë për marrëveshjen historike Kosovë - Serbi. Thaçi, i cili ka kërkuar heqjen e taksës për mallrat serbe, ka deklaruar se një marrëveshje e tillë ka mbështetjen e BE-së dhe të ShBA-së. Mirëpo opozita dhe një pjesë e pozitës kanë kritikuar qasjen e presidentit ndaj dialogut me Serbinë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 JANAR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, vazhdon të insistojë se Kosova duhet ta shfrytëzojë këtë vit marrëveshjen historike me Serbinë. Ai ka bërë me dije se tani është shansi më i mirë për marrëveshje me Serbinë. Kurse opozita dhe një pjesë e pozitës mendojnë se ai nuk po e bën gjënë e duhur në këtë proces.

Në profilin e vet në "Facebook", presidenti Thaçi ka shkruar se në një intervistë për Agjencinë e Lajmeve të Austrisë "APA" ka treguar për të mirat që do t'i kishin të dy vendet nga një marrëveshje ligjërishit e obligueshme. "Për Kosovën dhe Serbinë kjo do të mundësojë anëtarësimin në BE, derisa për Kosovën edhe në NATO. Nuk do të ketë kufij monoetnikë dhe të dy shtetet do të jenë shumetnikë. Arritja e një marrëveshjeje ligjërishit obliguese nënkupton që nuk do të ketë më kurrë luftë ndërmjet dy shteteve. Qytetarët do të kenë një jetë më të mirë sepse nga jetësimi i marrëveshjes do të përmirësohet edhe gjendja ekonomike dhe do të krijohen më shumë vende të punës, derisa kufijtë do të largohen, duke u bazuar në modelin evropian. Shansi për të arritur një marrëveshje të tillë asnjëherë nuk ka qenë më i mirë sepse e kemi mbështetjen e BE-së dhe ShBA-së", ka shkruar Thaçi. Sipas tij, risia është që edhe Rusia do të jetë në gjendje ta pranojë marrëveshjen nëse të dyja palët pajtohen. "Prandaj, është me rëndësi që të

shfrytëzohet ky momentum për të arritur një marrëveshje të balancuar, e cila merr parasysh interesat e dy vendeve. Në të kaluarën nuk ka pasur një gatishmëri të tillë. Nëse ne nuk e shfrytëzojmë këtë shans, atëherë qytetarët tanë do të na mallkojnë në dekadat e ardhshme. Kjo marrëveshje nuk ka të bëjë vetëm me korrigjimin e kufijve, por edhe me aspekte të tjera. Kjo marrëveshje do të jetë gjithëpërfshirëse dhe trajton çështje të tjera, si çështjen e personave të zhdukur nga lufta e fundit, të cilët edhe më tutje nuk janë kthyer në vendlindje", ka shkruar presidenti, duke shtuar se marrëveshja ka për qëllim t'i zgjidhë përfundimisht problemet dhe të mos jetë një zgjidhje e përkohshme, së cilës pastaj duhet t'i rikthehemi. "Nuk do të ketë as 'Shqipëri të madhe', as 'Kosovë të madhe'. Në vend të kësaj, synojmë integrimin e rajonit në Evropën e bashkuar. Në këtë intervistë kam folur edhe për ushtrimin e Kosovës. Ky ishte një vendim i duhur i një shteti sovran, i bazuar në vullnetin e popullit të Kosovës", ka vlerësuar Thaçi.

Por shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka vlerësuar se qasja e deritashme e presidentit Thaçi ndaj dialogut me Serbinë ka qenë e gabuar. Sipas tij, orientimi i gabueshëm që Hashim Thaçi kishte zbatuar në politikën e jashtme, sidomos në raport me Serbinë, e kanë sjellë Kosovën në gjendjen aktuale. "Qeveria aktuale e Kosovës me kryeministër Ramush Haradinajn ka marrë një rrugë tjetër në raport me Serbinë.



Ajo ka marrë disa vendime në mënyrë që t'u japë përgjigje adekuatë sulmeve të Serbisë kundër shtetit të Kosovës. Vendimi më i rëndësishëm është ai për taksën 100 për qind", ka shkruar Sherifi në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se presidenti do të bëjë çdo gjë që është në dorën e tij që ta detyrojë Qeverinë të heqë dorë nga politikat aktuale ndaj Serbisë. "Heqja dorë nga rruga që ka marrë Qeveria e Kosovës do të ishte vendim i gabuar sepse do ta inkurajonte Serbinë të mos ndryshojë qëndrimin ndaj Kosovës. Në të njëjtën kohë do të konfirmonte si të drejtë politikën nënshtruese të Thaçit karshi Serbisë. Nëse hiqet taksa pa u hequr arsytet që kanë çuar në

vënien e saj, gjithçka do të kthehet sërish në binarët e mëparshëm", ka shkruar Sherifi. Sipas tij, heqja dorë nga rruga e re e nisur nga kjo qeveri në një mënyrë do të ndikonte negativisht edhe në fazën e fundit të dialogut.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka deklaruar se presidenti dhe ky koalicion qeverisës e kanë të gabuar qasjen ndaj procesit të dialogut. "Çështjet e rëndësishme të veçantë, ku kërkohet përkushtim, vendosmëri dhe konsensus kombëtar, kanë marrë drejtim të gabuar. Dialogu me Serbinë po ndodh pa konsensusin e nevojshëm në mes të forcave politike, i udhëhequr nga përfaqësues politikë të palegjyritimit dhe nga bartës të institucioneve që

veprojnë përtej mandatit të tyre kushtetues. Ekipi negociator i formuar në dhjetor 2018, presidenti dhe kryeparlamentari, japin vlerësime kontradiktore për marrëveshjen e mundshme me Serbinë", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook", duke përmendur kontradiktat që kanë presidenti dhe kryeministri në këtë proces. "Njëri thotë se nuk do të ketë ndryshim të kufijve, tjetri se do të bashkohet Lugina e Preshevës. Njëri thotë se do të ketë shkëmbim të territoreve, tjetri se do të respektohet Kushtetuta. Njëri thotë se nuk do të humbim asgjë, tjetri thotë se marrëveshja do të jetë e dhimbshme. Njëri thotë se në fund vendos Kuvendi, tjetri thotë se vendoset me referendum", ka shkruar Hoti.

Veseli pret në takim "Remin": UÇK-ja luftoi në anën e drejtësisë

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh edhe kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka pritur në takim ish-komandantin e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, Rrustem Mustafën "Remi".

Veseli ka thënë se Kosova nuk ka frikë nga drejtësia. Sipas tij, UÇK-ja nga fillimi në fund qëndroi dhe luftoi në anën e drejtësisë. "Ishte kënaqësi të pres në zyrën time bashkëluftëtarin dhe mikun tim, 'Remin', pas kthimit të tij nga Haga. Qëndrimi i tij dinjitoz rreth

ftesës nga Gjykata Speciale është edhe një provë më shumë për luftën tonë të drejtë çlirimtare. Ne nuk kemi frikë nga drejtësia sepse UÇK-ja, që nga fillimi e deri në fund qëndroi dhe luftoi në anën e drejtësisë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Pezullimi i taksës,

- Po rrezikohen marrëdhëniet me ShBA-në



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Kosova duhet t'i trajtojë seriozisht kërkesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për pezullimin e taksës ndaj Serbisë. Ai ka theksuar se Amerika po sugjeron pezullimin e taksës por, në rast se dialogu do të dështonte, taksa do të vazhdonte me automatizëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka thënë se pezullimi i taksës është i domosdoshëm meqë po i rrezikon marrëdhëniet e Kosovës me aleatin kryesor, ShBA-në. Ai ka thënë se mund të vihet në pikëpyetje edhe ndihma për mbështetjen e ushtrisë së Kosovës. Sipas Maliqit, mesazhet e Uashingtonit janë kërcënime serioze dhe nuk duhet të neglizhohen

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 20 JANAR - Njohësi i proceseve politike, Shkëlzen Maliqi, ka thënë të dielën se qëndrimet e ndryshme të presidentit Thaçi dhe të kryeministrit Haradinaj nuk kanë të bëjnë me taksën si të tillë, por me marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se hapja e temës për korrigjim të kufijve ka frustruar kundërshtarët e tij në Kosovë. "Qëndrimet e ndryshme kushtëzohen jo me vetë taksën si të tillë, por me qëndrimet diametralisht të kundërta rreth

paketës ende të pahapur të marrëveshjes përfundimtare politike në mes të Kosovës dhe Serbisë që, si duket, është esencialisht e draftuar, sepse nuk do të përmendeshin afatet e shkurtra për aprovimin e saj", është shprehur Maliqi, duke shtuar se taksa ndaj mallrave serbe po shërben si element shtesë për bllokimin e dialogut, duke rrezikuar realizmin e marrëveshjes Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se Kosova duhet t'i trajtojë seriozisht kërkesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pezullimin e taksës ndaj Serbisë. Maliqi ka theksuar se pezullimi i taksës është i domosdoshëm meqë po i rrezikon marrëdhëniet e

Kosovës me Amerikën, aleatin kryesor. Madje ai ka thënë se mund të vihet në pikëpyetje edhe ndihma për mbështetjen e ushtrisë së Kosovës. "Pezullimi është i domosdoshëm sepse rrezikon jo vetëm marrëdhëniet tona me aleatin kryesor, por cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e ShBA-së", ka thënë ai. Sipas Maliqit, deri më tani angazhimi i ShBA-së na ka sjellë shpëtim dhe favore të konsiderueshme në shtetndërtim e jo dëme. "Qeveria jonë assesi nuk duhet të pengojë një proces mes superfuqive. Sigurisht, është legjitime nga ana e jonë të reflektojmë çfarë mund të na sjellë ky proces, por jo me

i domosdoshëm

dyshime paraprake, duke pasur parasysh përvojën se deri më sot angazhimi i ShBA-së na ka sjellë shpëtim dhe favore të konsiderueshme në shtetndërtim, assesi dëme", ka thënë ai. Sipas Maliqit, taksa po shërben si element shtesë për bllokimin e dialogut duke rrezikuar realizmin e marrëveshjes Kosovë - Serbi. "Nëse ai përfundon, siç pritet, me njohje të shtetit të Kosovës nga Serbia dhe në OKB, do të ishte gabim historik që të pengohet kjo nga frika spekulative", ka deklaruar ai.

"Epoka e re": Z. Maliqi, këto ditë është shtuar presioni ndaj Kosovës për heqjen e taksës ndaj produkteve serbe. Si duhet të veprojë kryeministri Haradinaj tash e tutje?

Maliqi: Kryeministri Haradinaj është dashur të reflektojë seriozisht ndaj presioneve e jo të insistojë me kryeneçësi për vazhdimin e taksës. Ai është kthyer sërish në një situatë si atëherë kur ishte kategorikisht kundër ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi pavarësisht prej qëndrimeve të amerikanëve dhe evropianëve se nuk ka të drejtë. Dhe, pasi na humbi shumë kohë, më vonë u detyrua, pasi u bë kryeministër, ta pranojë demarkacionin. Atij mbase i ka mbetur zhig pse atëherë u detyrua të lëshojë pe dhe tash po rreshtohet përkrah atyre që po thonë se çështja e taksave nuk i dëmton marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në. Por, ky është gabim sepse në mesazhin e ashpër nga Uashingtoni thuhet se përkrahësit e taksës do të ndëshkohen, madje përmenden me emra, sikundër që do të rishqyrtohen raportet me Kosovën, madje vihet në pikëpyetje ndihma për ngritjen e armatës së Kosovës. Këto janë kërcënime serioze dhe nuk duhet të neglizhohen.

"Epoka e re": Pse mendoni se

pezullimi i kësaj takse do të ishte zgjidhja e duhur?

Maliqi: Unë kam bërë një propozim se si do të duhej të vepronte kryeministri Haradinaj ndaj kërkesave të ShBA-së. Masa do të mbetej parimisht në fuqi, por ndaj Serbisë e pezulluar përkohësisht derisa zhvillohet dialogu. Edhe në mesazhin e ShBA-së implicite sugjerohet pezullimi e, nëse dialogu do të dështonte, atëherë do të vazhdonte me automatizëm. Ndërkaq, për Bosnjë Hercegovinën taksa nuk do të pezullohej. Ajo do të vazhdonte, por do të fillonin bisedimet në kuadër të CEFTA-s, që tashmë ka kërkuar Sarajeva, që këmbimi tregtar me këtë shtet të zhvillohet me kushte të barabarta. Një strategji e tillë do të nxirrte qeverinë dhe vetë Haradinajn faqebardhë por, si duket, ai dhe këshilltarët që i ka sikur janë dehur nga rritja e popullaritetit që ua ka siguruar taksa, kështu që nuk po shohin fare pasojat e kryeneçësisë.

"Epoka e re": Ka pasur deklarime në opinion se mbajtja e taksës po e rrezikon partneritetin me Amerikën e cila po insiston në heqjen e kësaj takse. A mund të ketë zbehje të partneritetit dhe të miqësisë ShBA - Kosovë?

Maliqi: Pezullimi është i domosdoshëm sepse rrezikon jo vetëm marrëdhëniet tona me aleatin kryesor, por cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e ShBA-së. Nuk është thjesht fjalë e gojës dhe kërcënim formal kur Uashingtoni përmend interesat e veta në një çështje që për ne është e madhe, por që dikush këtu e percepton si jo edhe aq të rëndësishme për ShBA-në dhe mund të na falë padëgjueshmërinë. Është një kor i tërë i kryeneçëve që këto ditë po përsërisin se taksa nuk mund ta prishë partneritetin dhe marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në.

Madje, ata i anashkalojnë krejtësisht porositë që vijnë nga Uashingtoni. Nëse administrata amerikane sot tregon vendosmëri për angazhim të drejtpërdrejtë në dialogun Kosovë - Serbi, në mënyrë që ai të përfundojë me marrëveshje politike obliguese në afate të shkurtra, ta kujtojmë letrën e presidentit Trump dy kryetarëve, Thaçit dhe Vuçiqit, duhet supozuar se vendosja e Kosovës në këtë lloj të agjendës të përshpejtuar nuk bëhet vetëm për ne, si një çështje në vete, por duhet të jetë pjesë e ndonjë plani më të gjerë çensionimesh mes ShBA-së dhe Rusisë. Qeveria jonë assesi nuk duhet të bëhet faktor që e pengon një proces mes superfuqive. Sigurisht, është legjitime nga ana jonë të reflektojmë çfarë mund të na sjellë ky proces, por jo me dyshime paraprake, duke pasur parasysh përvojën se deri më sot angazhimi i ShBA-së na ka sjellë shpëtim dhe favore të konsiderueshme në shtetndërtim, assesi dëme.

"Epoka e re": Kosova nuk është unike sa i përket çështjes së taksës, përderisa kryeministri e kryeparlamentari insistojnë se taksa nuk do të hiqet deri në njohjen e Kosovës nga Serbia. Nga ana tjetër, presidenti është për heqjen e taksës. Si e komentoni këtë qëndrim të ndryshëm të liderëve shtetërorë për taksën?

Maliqi: Qëndrimet e ndryshme kushtëzohen jo me vetë taksën si të tillë, por me qëndrimet diametralisht të kundërta rreth paketës ende të pahapur të marrëveshjes përfundimtare politike në mes të Kosovës dhe Serbisë që, si duket, është esencialisht e draftuar, sepse nuk do të përmendeshin afatet e shkurtra për aprovimin e saj. Se çka përmban konkretisht draftmarrëveshja janë ngritur shumë spekulime pas fushatës gjastëmujore vitin e kaluar rreth 'korrigjimit' të kufijve, që disa e kuptojnë si shkëmbim territorësh dhe të popullsisë, e disa si

copëtim të Kosovës. Fakti se presidenti Thaçi ka qenë ndër të parët që e hapi temën e korrigjimit në termet e ngjashme me projektet e mëparshme serbe i ka frustruar kundërshtarët të tij në Kosovë. Ata duke qenë të painformuar në detaje, e as sot nuk e dinë saktë se për çka konkretisht bëhet fjalë, na alarmojnë se po rrezikohet tërësia territoriale dhe sovraniteti i Kosovës. Taksa ndaj mallrave serbe tani shërben si element shtesë për bllokimin e dialogut, duke rrezikuar realizmin e marrëveshjes Kosovë - Serbi dhe festimit e saj në Shtëpinë e Bardhë, që e kishte paralajmëruar presidenti Trump në letrën të dhjetorit.

"Epoka e re": A parashihni vazhdim të procesit të dialogut në rast se taksa mbetet në fuqi? Nëse po, cila do të jetë dinamika e këtij procesi?

Maliqi: Pikërisht për këtë e kisha fjalën, kur thashë se taksa e rrezikon dialogun, sepse Serbia e kushtëzon dialogun me heqjen e taksës. Me këtë ajo fiton kohë dhe e paraqet Kosovën penguese të arritjes së marrëveshjes politike. Dialogu duhet të vazhdojë. S'po shoh se ka ndonjë alternativë për të qenë. Nga ana tjetër, për këta që reagojnë me panik patriotike, mua më duket se pezullimi i përkohshëm i taksës për disa muaj na mundëson që të shohim se çka po na sjell procesi i marrëveshjes. Nëse ai përfundon, siç pritet, me njohje të shtetit të Kosovës nga Serbia dhe në OKB, do të ishte gabim historik që të pengohet kjo nga frika spekulative. Aq më parë që i kemi garantitë se zgjidhjet eventuale të këqija nuk mund thjesht të na imponohen pasi në Kosovë me mjaft mund dhe dyshime është ndërtuar mekanizmi që pamundëson kalimin e vijave të kuqe të interesit kombëtar. Për t'u jetësuar marrëveshja politike ajo duhet të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës.

LDK-ja në Vushtrri festoi 29-vjetorin e themelimit

Vushtrri, 20 janar (ER) - Të dielën në Vushtrri u organizua manifestim me rastin e 29-vjetorit të themelimit të kësaj dege si një prej degëve të para të themeluara nga shumë aktivistë dhe veprimtarë. Në këtë manifestim të pranishëm ishin struktura të larta të partisë dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës në krye me sekretarin e përgjithshëm të LDK-së, Ismet Beqiri. Me këtë rast, kryetari i degës së LDK-së në Vushtrri, Hysni Gërguri, falënderoi veprimtarët dhe themeluesit e degës që në çdo

rrethanë dhanë kontribut të jashtëzakonshëm. Po ashtu, Gërguri në veçanti ka vlerësuar kontributin e veprimtarit, ish-kryetarit të Komunës së Vushtrrisë dhe Degës së LDK-së në Vushtrri, Hajzer Krasniqi. Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, ka falënderuar të gjitha strukturat e LDK-së për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë degës dhe komunës në përgjithësi. Tahiri ka folur edhe për të arriturat e qeverisjes komunale. Në emër të kryesisë së LDK-së, të

pranishmëve u është drejtuar sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri, i cili ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për të gjitha strukturat e Degës së LDK-së në Vushtrri, të cilat, sipas tij, kanë treguar gjithmonë gatishmëri dhe vullnet për të kontribuar në proceset e partisë dhe të vendit. Ai ka thënë se Dega e Vushtrrisë beson dhe ndjek vizionin e ish-presidentit Rugova. "Këtij modeli i kanë besuar edhe qytetarët e Vushtrrisë", ka thënë ai. Me vendim të kryesisë së degës,



mirënjohje dhe falënderim post-mortem i është dhënë familjes së themeluesit të Degës së LDK-së në

Vushtrri, ish-kryetarit të Komunës së Vushtrrisë dhe të degës, prof. Hajzer Krasniqi.

Mosrespektimi i ligjeve si burim i shkeljes së të drejtave të njeriut

PRISHTINË, 20 JANAR - Kosova ka shënuar përparim të ngadalshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këtë konstatim e ka nxjerrë edhe këtë vit Organizata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch. Sipas kësaj organizate, raportet ndëretnike, respektimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë, dhuna në familje, gjuha e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT-i dhe liria e mediave, janë ndër problemet kryesore me të cilat përballlet Kosova në fushën e mbrojtjes të së drejtave të njeriut.

Duke komentuar të gjeturat e raportit, anëtarja e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Kosovës, Lirie Kajtazi, ka thënë se Kosova përballlet me probleme serioze në respektimin e të drejtave të njeriut si pasojë e mosrespektimit të ligjeve. "Kemi shumë probleme të cilat besoj edhe si Komision për të Drejtat e Njeriut duhet të kërkojë më shumë mon-

itorim nga institucionet, agjencitë dhe nga forume të ndryshme të cilat do të ishin sjell më ndryshe, do t'i kryenin detyrat e veta. Vetë fakti se ligjet tona nuk respektohen as 50 për qind e asaj që është e shkruar, flet që ne jemi larg respektimit të disa të drejtave të njeriut në përgjithësi", ka thënë Kajtazi.

Raporti i Human Rights Watch po ashtu ka identifikuar si problem edhe dhunën në familje dhe reagimin e dobët të institucioneve të sigurisë. Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se gjatë vitit të kaluar kanë qenë tetë vrasje si pasojë e dhunës në familje, një prej tyre vrasja e Valbona Markut dhe vajzës së saj, vrasje kjo që, sipas Berishës, ndodhi nga neglizhenca e policisë dhe prokurorisë. "Sistemi i drejtësisë ka ngecje duke filluar nga zinxhiri i parë që është policia, pastaj edhe deri te shqiptimi i dënimeve nga gjykatat. Kemi

parë shpesh që gjyqësia nuk i dënon ushtruesit e dhunës në familje karshi Kodit Penal dhe dënimeve që parashihen për dhunën në familje", është shprehur Berisha.

Mes të tjerash, Human Rights Watch ka përmendur edhe problemet me të cilat përballen komunitetet pakicë. Deputeti nga radhët e komunitetit egjiptian, Veton Berisha, ka theksuar se komunitetet joshumicë, kryesisht nga ai rom, ashkali dhe egjiptian, përballen me probleme ekzistenciale. Berisha thotë se të gjeturat e raportit duhet t'u shërbejnë institucioneve të Kosovës si një tregues për përmirësimin e gjendjes. "Sidomos në fushën e punësimit ende është niveli i njëjtë. Nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Përfaqësimi ynë në sektorët e sigurisë siç është Policia, siç është FSK-ja, gardianët e burgut, siç janë institucionet në të cilat ne do të duhej të përfshiheshim,

nuk numërojmë numër të caktuar që institucioni ka ndërmarrë ndonjë veprim që mund të konsiderohet si rezultat", ka deklaruar Berisha. Ai ka theksuar se progresi i vogël është duke u shënuar në arsimimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve pasi, sipas tij, është zvogëluar numri i personave që nuk vijojnë mësimin, të paktën atë fillor dhe të mesëm. Në raportin e publikuar më 17 janar nga Human Rights Watch përmenden diskutimet mbi ndryshimet e mundshme të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe shqetësimet për të drejtat e njeriut, në rast të transferimit të popullatës.

Organizata thekson se tensionet ndëretnike në Kosovë kanë vazhduar edhe në vitin 2018, sidomos në pjesën veriore. Raporti flet edhe për gjuhë të urrejtjes kundër aktivistëve të të drejtave të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve. Sipas të njëjtit raport, kërcënimet

dhe sulmet kundër gazetarëve kanë vazhduar edhe në vitin 2018, ndërsa hetimet dhe përndjekjet kanë qenë të ngadalshme. Mes të tjerash, raporti ka përmendur edhe dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova në muajin mars të vitit 2018, duke thënë se ata kanë pasur vendbanim të ligjshëm në Kosovë dhe se janë dëbuar pa ndonjë proces paraprak dhe duke shkelur masat kundër dëbimit të dhunshëm.

Për problemet me të cilat përballlet Kosova në këtë fushë vazhdimisht ka alarmuar edhe institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë.

Avokati i Popullit kishte konstatuar se administrata publike është një nga shkelësit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut. Ky institucion ka pranuar numër të lartë të ankesave nga qytetarët kundër gjykatave, që kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave gjyqësore për vendosjen e rasteve të tyre.



EPIK-u: Mungesa e reformave humbi 11 milionë euro, rrezikohen edhe 14 milionë të tjera

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Instituti EPIK ka bërë me dije të dielën se mungesa e reformave i ka humbur Kosovës 11 milionë euro si dhe është duke ia rrezikuar edhe 14 milionë të tjera. Ky institut u ka bërë thirrje institucioneve shtetërore që ta shtojnë angazhimin drejt përmbushjes së treguesve me qëllim të avancimit të reformave në fushën e administratës publike dhe evitimit të humbjes së 25 milionë eurove që do të mund të orientoheshin në shërbim të

qytetarëve. "Në vitin 2018 është dashur të bëhet disbursimi i transhit fiks në vlerë prej 5.5 milionë eurosh si dhe të përmbushen njëmbëdhjetë treguesit që do të lejonin disbursimin e transhit të parë variabël në vlerë prej 5.5 milionë eurosh. Në këtë drejtim, në bazë të analizës të Institutit EPIK, vlerësojmë se institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të zbatojnë tërësisht asnjë nga njëmbëdhjetë treguesit që është dashur të përmbushen deri në fund të vitit

2018 dhe si rezultat i kësaj Kosova ka humbur 11 milionë euro. Me këtë trend të reformave, Kosova rrezikon ta humbasë edhe pjesën e mbetur në vlerë prej 14 milionë eurosh", është thënë në komunikatën e këtij instituti. Sipas EPIK-ut, mospërmbushja e reformave të pajtuara, përveçse do të këtë pasojë humbjen e mjeteve financiare, në të njëjtën kohë do ta dëmtojë reputacionin e vendit tonë si partner kredibil para komunitetit ndërkombëtar.



Vazhdon mungesa e transparencës në uebfaqet e partive politike

	FUNKSIONALE	TË DHËNA PËR UDHË-HEQËSINË	DOKUMENTAT KRYESORE	RAPORTET FINANCIARE	RAPORTET E FUSHATËS 2017	PËRDITËSIMI	INFO PËR ANËTARËSIM	INTERAKTIVE /DISKUTIM	DYGJUHËSH
LVV	✓	Pjesërisht	✓	Pjesërisht	✓	Pjesërisht	✓	✓	✗
PDK	✓	✓	✓	✗	✗	✓	✓	✗	✗
NISMA	✓	Pjesërisht	✓	Pjesërisht	✗	✓	✗	✗	✗
LDK	✓	✓	✗	Pjesërisht	✗	Pjesërisht	✗	✗	✗
AAK	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗

raportin financiar për fushatën e vitit 2017, por nuk ka publikuar raportin e rregullt financiar për këtë vit. Lajmi i fundit i publikuar në uebfaqen e kësaj lëvizje është i 2 qershorit 2018. Po ashtu, ky subjekt politik nuk ka përditësuar as të dhëna të tjera me rëndësi siç janë grupi parlamentar, ku ende figurojnë edhe individët që tashmë kanë kaluar në një subjekt tjetër politik", është theksuar në komunikatë.

Ndërkaq Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është i vetmi subjekt që nuk ka as përmirësim e as përqendrim të gjendjes. Sipas "Demokrasi Plus"-it, ky subjekt vazhdon të mos i publikojë raportet e veta financiare përditërisht e përditëson atë me lajme të ndryshme nga aktivitetet e ndryshme partiake. "Nisma Socialdemokrate të vetmin përmirësim që e ka ky subjekt politik është përditësimi më i shpeshtë. Në anën tjetër, vazhdon të mos ketë të publikuara të gjitha raportet e shpenzimeve financiare si dhe nuk ka të dhëna të plota për udhëheqësin e këtij subjekti. Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka asnjë përmirësim nga periudha paraprake e krahasimit. Përkundrazi, nuk ka publikuar të gjitha raportet financiare, duke përfshirë edhe atë fushatës zgjedhore 2017. Po ashtu, edhe përditësimi me lajme të reja nuk bëhet në baza të rregullta. Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës si duket të qenit në pushtet i mjafton dhe e ka çaktivizuar në tërësi uebfaqen e vet", është bërë me dije në komunikatën e "Demokrasi Plus"-it.

"Demokrasi Plus" ka vazhduar t'i përcjellë uebfaqet e subjekteve kryesore politike. Nëse krahasohet gjendja aktuale me atë të tetorit të vitit 2017, kur ishte publikuar infografika e fundit, vërehet që pothuajse të gjitha subjektet ka përqendrim në aspekt të mirëmbajtjes së uebfaqeve

nikatë të "Demokrasi Plus"-it. "Demokrasi Plus ka vazhduar t'i përcjellë uebfaqet e subjekteve kryesore politike. Nëse krahasohet gjendja aktuale me atë të tetorit të vitit 2017, kur ishte publikuar infografika e fundit, vërehet që pothuajse të gjitha subjektet ka përqendrim në aspekt të mirëmbajtjes së uebfaqeve. I vetmi subjekt politik që ka mbajtur situatën e njëjtë, por që nuk ka shënuar as përmirësim, duke i munguar edhe disa informata bazike, është Partia Demokratike e Kosovës", është theksuar në këtë komunikatë. Sipas "Demokrasi Plus", subjektet politike vazhdo-

jnë të mos kenë transparencë të plotë sa i përket publikimit të raporteve financiare. "Asnjëra prej subjekteve politike nuk ka publikuar raportet vjetore financiare të vitit 2017, ndërsa vetëm Lëvizja Vetëvendosje ka publikuar raportin financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2017", është bërë me dije në komunikatën e "Demokrasi Plus"-it. Sipas kësaj organizate, Lëvizja Vetëvendosje, edhe pse ka një përqendrim nga periudha paraprake, vazhdon të mbetet subjekti me uebfaqen më të mirëmbajtur nga të gjitha subjektet politike. "Ky subjekt politik ka publikuar

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 JANAR - Partitë politike garojnë për besim të votuesve në zgjedhje dhe marrin fonde nga buxheti i Kosovës, andaj pritjet që në uebfaqet e tyre ato së paku të

ofrojnë informata dhe dokumente themelore, që janë lehtë të qasshme për publikun dhe simpatizantët. Mirëpo, shumë parti politike ende po vazhdojnë ta injorojnë mirëmbajtjen e uebfaqeve jashtë procesit zgjedhor. Kështu është thënë në një komu-

SBASHK-u: Greva vazhdon. Mos na bëni presion

EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 20 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se do të vazhdojë greva në tërë sistemin arsimor derisa institucionet e shtetit nuk përmbushin kërkesën për ngritjen e koeficienteve në Projektligjin e pagave për 30 për qind për të gjithë të punësuarit në arsimin e Kosovës. Kjo sindikatë ka ftuar institucionet qendrore dhe lokale që t'i shtojnë angazhimet për ta përmbushur kërkesën e tyre. SBASHK-u ka kërkuar ndaljen e presionit ndaj grevistëve meqë, sipas kësaj sindikate, punëtorët e arsimin nuk mund t'i largojë askush nga e drejta e tyre e garantuar me ligj. "Po ashtu, i kujtojmë ata që të heqin dorë nga idetë për të bërë presion ndaj grevistëve sepse do të

përballen me ligjin e drejtësinë ngaqë greva jonë është legjitime dhe këtë të drejtë e mbron edhe Ligji mbi grevat dhe konventat ndërkombëtare. Punëtorët e arsimin nuk ka mundur t'i frikësojë e t'i largojë nga misioni i tyre i shenjtë as pushtuesi serb me gjithë atë dhunë në vitet '90. Punëtorët e arsimin nuk mund t'i largojë as sot e gjithë ditën askush nga e drejta e tyre e garantuar me ligj për ta shprehur kundërshtimin e tyre përmes grevës legale ndaj ligjit diskriminues e degradues të pagave. Ne nuk po kërkojmë as më shumë e as më pak se të tjerët, prandaj do të qëndrojmë të palëkundur në angazhimet dhe përpjekjet tona për ta realizuar kërkesën e drejtë për ngritje së paku për 30 për qind të koeficienteve për të punësuarit në tërë sistemin arsimor", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.



Auditimi i ndërmarrjes 'Trepça', i domosdoshëm



Deri më sot ndërmarrja "Trepça" nuk ka pasur auditim të jashtëm dhe kjo ka bërë që të mos dihen shumat e sakta të detyrimeve të kësaj ndërmarrje e cila ndodhet në kalimin e tranzicionit nga ndërmarrje shoqërore në shoqëri aksionare. Kryeauditori Besnik Osmani ka bërë me dije se kanë marrë një kërkesë për auditim të kësaj ndërmarrje nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, por nuk ka ndonjë datë të saktë se kur pritet të fillojë ky auditim. Njohësi i çështjeve ekonomike, Muhamet Mustafa, ka theksuar se ky auditim mund të marrë kohë dy apo tre muaj

cili nuk ka treguar ndonjë datë konkrete se kur pritet të fillojë auditimi. "Në këtë moment nuk mund të komentojmë më shumë në lidhje me këtë çështje", është shprehur Osmani. Lidhur me këtë çështje, kryesuesi i Bordit të "Trepçës", Ardian Sylja, ka thënë se auditimi i kësaj ndërmarrje ishte kërkesë e kamotshme e bordit. "Nga deklarata publike që ka bërë ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, kemi kuptuar se i është drejtuar auditorit gjeneral. Realisht kjo ka qenë temë diskutimi disa herë kur jemi takuar me ministrin, pra ishte edhe kërkesë e jona si bord. Ne para disa kohësh kemi takuar auditorin gjeneral dhe e kemi ftuar edhe nga komiteti i auditimit që të vijin në ndërmarrje ta bëjnë auditimin, pastaj kishte mbetur që ministri t'u drejtohej me një shkresë. Bazuar në këtë, mund të themi se kërkesa e ministrit Lluka është veprim për t'u përshëndetur. Në fazën në të cilën gjendet ndërmarrja, atë të transformimit nga ndërmarrje shoqërore në shoqëri aksionare, na duhet patjetër një pasqyrë e saktë e të gjitha borxheve dhe detyrimeve. Pra, na

duhet një pasqyrë e saktë para se të regjistrohet ndërmarrja në shoqëri aksionare, gjë që pritet të ndodhë shumë shpejt pas miratimit të draftstatutit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës", ka thënë ai. Sylja ka shtuar se me këtë auditim do të kenë një pasqyrë të të gjitha aktiviteteve të ndërmarrjes qoftë financiare apo operative. I pyetur se nëse kishte auditim të brendshëm në këtë ndërmarrje ashtu siç e parashihet Ligji për Ndërmarrjet Publike, Sylja ka theksuar se ekziston zyra për auditim të brendshëm në ndërmarrjen "Trepça" dhe menjëherë pas regjistrimit të ndërmarrjes pritet të zgjedhën edhe organet menaxhuese. "Pra, do të zgjedhen edhe zyrtarët e lartë që i parashihet Ligji për ndërmarrjet publike dhe në kuadër të këtyre zyrtarëve është edhe zyrtari për auditimin e brendshëm që i përgjigjet komitetit të auditimit dhe komiteti i auditimit është pjesë e bordit. Pastaj kur të zgjedhet zyrtari kryesor i auditimit, formohet edhe zyra e auditimit të brendshëm në kuadër të standardeve dhe normave që kërkohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike", ka bërë

me dije Sylja. Sa i përket kohës potenciale të auditimit, ai ka thënë se nga paslufta nuk është bërë auditim i jashtëm i kësaj ndërmarrje. Ai ka kërkuar që auditimi të fillojë sa më parë. "Po e përsëris sërish se disa herë kemi pasur takime dhe në cilësinë e kryesuesi të bordit kam kërkuar që sa më parë të fillojë auditimi në ndërmarrjen "Trepça" pasi nuk është bërë asnjëherë deri më tani një auditim nga auditori gjeneral dhe është e domosdoshëm që auditori gjeneral të përfshihet në auditimin e ndërmarrjes. Aktualisht nuk kemi informacione se sa do të zgjasë dhe kur do të fillojë auditimi për shkak se kjo varet nga kapacitetet dhe mundësitë e ZAP-it. Pasi statuti është në prag të kalimit do të ishte e udhës që sa më parë të fillojë auditimi në mënyrë që ta kemi vijën ndarëse apo prerjen e saktë si në aspektin financiar, po ashtu edhe në atë operativ", ka thënë Sylja. Njohësi i çështjeve ekonomike, i cili në mandatin e kaluar ishte kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Muhamet Mustafa, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se auditimi i kësaj ndërmarr-


EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 JANAR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, më 12 janar të këtij viti, ditën kur edhe u pajtua me këshillin grevist dhe Sindikatën e Punëtorëve të "Trepçës" që të ndërpritet greva e punëtorëve, ka bërë me dije se ka kërkuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit që ta bëjë auditimin e kësaj ndërmarrje. "Kam dërguar kërkesë për auditim tek Auditori i Përgjithshëm në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë të


kësaj ndërmarrje", kishte deklaruar ministri Lluka. Ndërkaq auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka pranuar kërkesën e ministrit Lluka. Ai ka thënë se kjo kërkesë është duke u trajtuar në kuadër të kompetencave ligjore. "Auditori i Përgjithshëm ka pranuar kërkesën nga ministri Lluka për auditimin e ndërmarrjes 'Trepça'. Ne jemi duke e trajtuar kërkesën nga kuadri i kompetencës ligjore dhe kapaciteteve në dispozicion dhe për këtë duhet një kohë e arsyeshme", ka thënë Osmani, i

rje është më se i domosdoshëm edhe pse, sipas tij, është hap i vonuar. "Auditimi është më se i domosdoshëm, pasi duhet të konstatohen se apo çfarë shume duhet të jenë aksionet, edhe pse është dashur të bëhet moti auditivi, në mënyrë që të konsolidohet gjendja financiare dhe ta dimë saktë, pastaj të shkojmë përpara", ka thënë Mustafa, duke shtuar se kjo çështje duhet të ecë shumë shpejt pasi ka

vonesa shumë të mëdha. "Që nga miratimi i ligjit kanë kaluar dy vjet e gjysmë. Moszbatimi i ligjit ka pasur pasoja të rënda. Me këtë ligj 'Trepça' bëhet një korporatë moderne, por ky ligj duhet të zbatohet dhe të eliminohen vështirësitë. Auditimi mund të marrë kohë dy apo tre muaj. Në këtë kuadër duhet të kryhen edhe punët e tjera", ka thënë Mustafa.



Rekorde të arritura si asnjëherë më parë në historinë e termocentraleve të KEK-ut



Njazi THAÇI

"Kosova B"

"Njësia B2" është në punë, në prodhim pandërprerë që nga data 25. 9. 2018. Me kapacitete të plota prodhuese prej 284 MW/h energji elektrike, njëkohësisht me 25 MW energji termike nga ku mundësohet ngrohje e kryeqytetit, Prishtinës. Nëse llogaritet me ditë pune, është fjala pa ndërprerje fare, kjo njësi nuk është ndalur së prodhuari mbi 110 ditë pune. Ky është një rekord që nuk është arritur

asnjëherë më parë që nga lëshimi në punë para rreth 30 vjetëve. Rekord tjetër është edhe fakti që në total gjatë vitit 2018 kjo njësi ka qenë në prodhim për 11 muaj e 8 ditë, pra ka pasur vetëm 21 ditë ndalesa gjatë gjithë vitit.

Me këto statistika kjo njësi besojmë se ka thyer rekordet e secilit termocentral tjetër në rajon dhe shtete të BE-së me më së shumti orë pune brenda një viti krahasuar me termocentralet që prodhojnë energji elektrike nga thëngjilli. Nuk përfundon me kaq.

Edhe "Njësia B1", e TC "Kosova B", pas një remonti të suksesshëm, është me prodhim pa asnjë ndalesë nga data 13. 12. 2018. Kjo njësi është duke prodhuar po ashtu me kapacitet maksimal prej 295 MW/h energji elektrike dhe 45 MW energji termike për ngrohje të Prishtinës.

"Kosova A"

Edhe rezultatet në termocentralet e "Kosova A" do ta befasojnë secilin profesionist të kësaj fushe nëse merret parasysh vjetërsia e tyre. Prodhimi i elegjisë elektrike në njësitë e "Kosova A" janë rritur për 100 për qind krahasuar me vitin paraprak. Asnjë rënie e paplanifikuar gjatë kësaj pjese të sezonit të dimrit. Pa ndërpre gjatë gjithë kohës në prodhim dhe në gjendje shumë të mirë. Këto rezultate janë arritur falë një angazhimi maksimal dhe kujdesi të vazhdueshëm e, po ashtu, mirëplanifikimit të investimeve. KEK-u vazhdon të jetë në prodhim me kapacitete të plota prodhuese prej 800 MW/h energji elektrike. KEK-u është dhe do të vazhdojë të jetë stria më e suksesshme në vend, edhe me rezultatet më të mira në nivel rajoni dhe më gjerë.

Ministri Rikalo takon ministren e Bujqësisë së Gjermanisë, Julia Klockner

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Gjatë qëndrimit në Berlin, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, ka takuar ministren e Ushqimit dhe Bujqësisë të Gjermanisë, Julia Klockner, gjatë takimit të organizuar nga SWG me ministrat e bujqësisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë këtyre takimeve është biseduar për mundësinë e përkrahjes së Kosovës nga Republika Federale e Gjermanisë përmes projekteve të ndryshme, duke avancuar kështu edhe më shumë sektorin e bujqësisë në vendin tonë. Ministria gjermane Klockner

është zotuar se do ta vazhdojë përkrahjen për Kosovën si dhe do ta ndihmojë sektorin e bujqësisë që të avancojë më shumë në procesin e integritimit evropian, konkretisht në mbarëvajtjen dhe përbushjen e obligimeve që vijnë nga procesi i MSA-së. Ndërsa ministri Rikalo ka falënderuar Klocknerin për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen që po ofron shteti gjerman për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë, i cili, sipas tij, ka qenë shumë konkret përmes Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë dhe GIZ-it gjerman.



Banorët e Gërdocit protestojnë në lidhje me punësimet në Burgun e Sigurisë së Lartë

Podujevë, 20 janar (ER) - Banorët e fshatit Gërdoc të Podujevës kanë protestuar pranë Burgut të Sigurisë së Lartë në këtë vend pasi, sipas tyre, ka pasur padrejtësi në punësimin në këtë institucion. Banorët e këtij fshati kanë pohuar se kur është hapur burgu u ishte premtuar se në kushte të barabarta me kandidatët e tjerë do të kenë përparësi ata që vijnë nga ky fshat. Sipas tyre, gjashtë kandidatë nga ky fshat që konkurruan në konkursin e fundit të shpallur

nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për 120 gardianë janë përballur me padrejtësi. Një nga protestuesit, i cili kishte aplikuar për njërin nga vendet e punës, Leutrim Bajrami, ka thënë se nuk është pranuar pavarësisht se ka pasur sukses në të gjitha fazat e testimit përderisa, sipas tij, ka pasur aplikues që janë pranuar me më pak pikë. Protestuesit pas rreth gjysmë ore proteste të qetë janë shpërndarë dhe kanë paralajmëruar se do të organizojnë protesta të tjera.



Ramosaj sot takohet me sindikalistët e arsimit në Deçan

DEÇAN, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se sot (e hënë) do të takohet me Sindikatën e Arsimit në këtë komunë për të diskutuar në lidhje me grevën. Ai ka thënë se do të takohet me sindikalistët e arsimit pas ankesave të qytetarëve që kanë ardhur në adresë të tij

për shkak të grevës. "Pas situatës së krijuar me grevën në sektorin e arsimit, e organizuar nga Sindikata e Arsimit, dhe pas shprehjes së shumë ankesave qytetare dorëzuar në drejtuar zyrën time, deri në organizim protestues, për të hënë në zyrën time kam ftuar Sindikatën e Arsimit dhe

aktorët e tjerë për ta rishikuar kërkesën dhe formën e veprimit të tyre për ta realizuar rritjen e pagave", ka thënë Ramosaj. Ai ka ftuar qytetarët dhe mësimdhënësit që të jenë në krye të detyrës. "Si kryetar, me respekt i ftoj qytetarët dhe mësimdhënësit që të jenë në nivelin që kërkohet nga ne", ka thënë Ramosaj.

Hoxhaj: Sakrifica e Samiut dhe Afrimit është themel i pavarësisë sonë

MITROVICË, 20 JANAR - Në Qendrën e Kulturës në qytetin e Mitrovicës është mbajtur të dielën akademi përkujtimore për dy dëshmorët e rënë gjatë luftës së fundit në Kosovë, Sami Gashin dhe Afrim Hajrizin. Në këtë akademi kanë marrë pjesë përfaqësues institucionale, ndër ta edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, i cili ka thënë se sakrifica e Samiut dhe Afrimit është themel i pavarësisë së Kosovës.

Hoxhaj në emër të kryeparla-

mentarit të Kosovës, Kadri Veseli, ka falënderuar të pranishmit në këtë akademi. "20 janari është një ngjarje e veçantë për Mitrovicën, për Kosovën dhe për kombin shqiptar kudo që bukës i thonë bukë e ujit i thonë ujë. Është një ditë që ka të bëjë me themelin e lirisë sonë. Ne sot jemi mbledhur pas 20 vjetësh që ta shënojmë këtë ngjarje të rëndësishme për Kosovën", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se duke kujtuar Samiun dhe Afrimin, kujtojmë rrugën e lirisë. "Vepra e tyre është synimi



më i mirë për ta kuptuar rrugën e gjatë që ne kemi bërë si popull për lirinë tonë. Sakrifica e Samiut dhe Afrimit është themel i pavarësisë sonë. Kemi bërë përpjekje që ta përmirësojmë gjendjen ekonomike dhe ta forcojmë Kosovën", është shprehur Hoxhaj.

Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se Kosova nuk po bëhet ashtu siç kanë dashur dëshmorët. "Nuk po e udhëheqim vendin ashtu si ata kanë dashur", ka thënë Bahtiri.

Mbahet tryeza shkencore për Mulla Idriz Gjilanin

GJILAN, 20 JANAR (ER) - Manifestimi kulturor "Flaka e Janarit 2019" ka vazhduar aktivitetet me tryezën shkencore me temë "Mulla Idriz Gjilani - një figurë e pashembullt e qendrës shqiptare", në përkujtim të 70-vjetorit të martirizimit të tij. Në këtë simpozium janë paraqitur historianë nga të gjitha trevat shqiptare, të cilët me punimet e tyre shkencore kanë ndriçuar edhe më shumë figurën e Mulla Idriz Gjilanit. Naim Musliu, kryetar i Lidhjes së Historianëve "Ali Hadri", Dega në Gjilan, i cili ka hapur tryezën, Mulla Idriz Gjilanin e ka cilësuar figurë të lartë shqiptare dhe ka rikujtuar që në emër të lidhjes ka kërkuar



që këtij njeriu të madh t'i ngrihet përmendorja në Gjilan.

Në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në kuadër të manifestimit "Flaka e Janarit 2019", ka folur Shpresa Kurteshi-Emini, e cila ka thënë se Gjilani po nderon heronjtë që nga Skënderbeu e deri te figurat më të vonshme të luftës për çlirim. Isa Mullaidrizi, i biri i Mulla Idriz Gjilanit, ka evokuar kujtime

për babanë e vet, duke thënë se kjo është ditë e madhe për pasardhësit e Idriz Gjilanit, ditë rilindjeje, ditë e kujtimit të jetës dhe veprës së këtij atdhetari.

Isa Mullaidrizi ka rikujtuar fjalët e babait të tij, duke theksuar: "Kosova është tokë e shtrenjtë që askujt nuk ia kemi grabitur". Në këtë tryezë Sabile Keçmezi-Basha është paraqitur me kumtesën "Nënë Hatixhja, grua trime e Mulla Idrizit". Ajo ka theksuar se bashkëshortja e Mulla Idrizit, Hatixhja, edhe pse ka kaluar nëpër shumë vështirësi, ajo kurrë nuk u dorëzua, ku edhe ishte arrestuar për t'u zbuluar vendndodhja e Mulla Idrizit.

Përkujtohen Ahmet Kaçiku dhe Vezir Jashari në 20-vjetorin e rënies

FERIZAJ, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me deputetin e Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, drejtorë të drejtorive komunale, kryetarin e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi, përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Ferizaj, familjarë të dëshmorëve si dhe dhjetëra qytetarë, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në përkujtim të rënies heroike të komandantit të Brigadës 161 të Zonës Operative



të Nerodimes, Ahmet Kaçiku, si dhe dëshmorit të kombit Vezir Jashari. Me këtë rast, Aliu ka thënë se Ahmet Kaçiku dhe Vezir Jashari janë shembulli më i mirë, ku trimëria, zgjuarsia dhe atdhedashuria farkojnë lirinë e popullit tonë. Veprën e dy dëshmorëve e ka vlerësuar lart edhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi.

Pronosim në dokumentarin me rastin e 1 vjetorit të ndarjes nga jeta!
Kushtuar jetës dhe veprës së Liderit të Luginës së Preshevës Jonuz Musliu

JONUZ MUSLIU, NJË JETË LUFTË PËR ATDHE

Për Jonuz Musliu, për jetën, për veprimtarinë e tij, për kontributin në çështjen kombëtare, unë kam dëgju para se me u taku fizikisht.

Nderkaq personalisht e kam taku pas përfundimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e kam taku në Gjilan.

Me Jonuz Musliu angazhimin e parë të përbashket e kemi pas, në Këshillin për Rivarrim të dëshmorëve të Zonës Operative të Karadakut!

Jonuzi ka gene anëtar i Këshillit. Unë mendoj që figura e Jonuz Musliut është figurë e madhe e kombit dhe si e tillë ajo sa më shumë që të kalon koha do të rritet në përmasa shumë të mëdha.

Kontributi i tij është i madh në çështjen kombëtare.

Mendoj që në historinë e popullit shqiptar, do të jetë një nga figurat, që do të radhitet përkrah figurave të mëdha të kombit, që ka kontribuar shumë për luftën, për çlirim nga Serbia pushtuse.



Duke qen përfaqesuesi politik i Ushtrisë për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, duke e mbuluar me dashuri të jashtëzakonshme ndaj luftës për liri, ndaj çështjes së pazgjidhur shqiptare të Luginës së Preshevës, Ai ka përfaqësuar politikanin shqiptar që në mënyrë permanente, vazhdimisht nuk është kursyer

për asgjë. Neve shokëve të Kosovës, por edhe te viseve të tjera, padiskutim që kemi ndjerë dhembje, sepse Ai edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, dhe pas përfundimit të luftës së UÇPMB-së ashtu siç përfundoi, megjithatë Ai ka qenë politikanin që ka qenë në gojë të ujkut, ka qenë në zjarrë, ka qenë në flakë.



Për Të edhe pas përfundimit të luftës, lufta nuk ka përfunduar. Vdekja e hershme e Jonuz Musliut ka qenë, humbje e madhe për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe humbje dhe goditje shumë e rëndë për lëvizjen politike paqedashëse dhe çlirimtare të Luginës së Preshevës. Iu mbetet gjeneratave të

ardhshme të Luginës së Preshevës në veçanti dhe popullit shqiptar në përgjithësi që figurën e Jonuz Musliut, ta nderojnë e ta respektojnë, ta mbajnë në pedestalin ku Ai e ka vendosur, me kontributin dhe angazhimin e Tij maksimal dhe të jashtëzakonshëm.

Ismet SYLEJMANI
Gjilan, më 18 Janar 2019

Shqiptarët kurrë nuk kanë cenuar interesa të miqve e as të armiqve



Jakup KRASNIQI

Mënyra se si janë duke komunikuar disa njerëz të politikës shqiptare, të nivelit të lartë në ditët tona, është bukur vështirë që të kuptohen se në të vërtetë çka janë duke kërkuar ata në politikë dhe kujt janë duke ia bërë argatin? Ajo që lehtë është e vërejtshme është fakti se ata nuk janë as të angazhuar e as të interesuar që t'i mbrojnë interesat e vendit të tyre për çka janë të thirrur. Kjo është shumë e dukshme. Të kujt interesa politike janë duke mbrojtur nuk është lehtë që të dihen e të thuhën, por nëse kemi parasysh faktin se shumë njerëz të politikës sonë që sa vite janë kryekreje në mbrojtje të interesave individuale ekonomike e aspak të interesave politike dhe ekonomike të kombit e të shtetit që e përfaqësojnë. Nisur nga kjo, nuk është vështirë për të konstatuar se edhe në rastet politike

të ditëve të fundit, e sidomos në atë që ka të bëjë me taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe, ata janë duke i mbrojtur interesat kryekreje personale e aspak shtetërore e kombëtare.

Ai apo ata që taksën ndaj Serbisë e Bosnjës, sidomos ndaj Serbisë, e konsiderojnë si një veprim a teke personale të një lideri shtetëror e cilat "teke nuk guxojnë të lëndojnë interesin tonë shtetëror dhe atë strategjik të ShBA-së"?! Diçka të tillë sikur të thoshin nostalgjikët e Beogradit, që nuk mungojnë në Kosovë, të cilët tani janë të heshtur, por që nxjerrin kokën kohë pas kohe, mbase edhe do të kuptoheshin disi! Por kur këtë e thotë njeriu i parë i vendit dhe zyrtarët e lartë të një partie politike që pretendojnë në të ardhmen ta qeverisin vendin, nuk është aspak lehtë të kuptohen?! Nuk kuptohen për faktin se shqiptarët që nga koha e konsolidimit si komb (1878-81) e këndeje, askush e as historia si mësuese e jetës nuk na tregojnë e as mund të konfirmojnë se ne, shqiptarët, kemi pasur mundësi që t'i lëndojmë interesat e armiqve, se jo më ato të miqve?! Vështirë është që t'i kuptojmë këta njerëz të cilët dinë t'ua drejtojnë gjithë meritë e zotave të Olimpikut, vendit e

kombit të tyre?! Vërtet është vështirë për t'i kuptuar ata që as historia e as jeta e tyre nuk i ka bërë që të kuptojnë e të dinë se shqiptarët kanë një respekt të veçantë ndaj mikut, ndërsa armiqët nuk kanë pasur mundësi t'i lëndojnë asnjëherë të vetme, por kanë ditur të lëndojnë shumë vendin e kombin e vet. E kanë lënduar aq sa kanë lënë më shumë se gjysmën e tokave e popullit jashtë shteteve të tyre e janë vlarë e prerë si është më se keqi mes vete. Duhet ta kujtojmë periudhën 1913-1925, kur shqiptarët humbën toka e personalitete për teket e ndonjë pashai a mbreti. Por, si po duket, dikujt në mesin tonë i është lënduar shumë kujtesa, madje edhe kujtesa e viteve të fundit, gjatë të cilave vite, kur Serbia më se tri herë nuk ka qenë në gjendje ta pranojë asnjë marrëveshje të vetme ndërkombëtare me Kosovën. Madje ajo vazhdon të deklarojë se: "Ne do të vazhdojmë këtë proces, nuk do të pajtohemi me situatën që dikush do të na detyrojë ta njohim Kosovën shtet". Kështu deklaruan dje zyrtarët të lartë të Serbisë. Kjo do të thotë që sa më shumë që të nënshtrohen të parët tanë si Thaçi e zyrtarët të LDK-së, aq më shumë do

të trimërohen ata që nuk u distancuan as edhe një herë nga politika e gjenocidit serb.

Taksa që Kosova e vendosi ndaj Serbisë ka ardhur edhe pas gjashtë-shtatë vjetëve të bisedimeve të Brukselit në mes të Kosovës e Serbisë, ku Serbia as edhe një herë nuk ka treguar asnjë gatishmëri për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën, përkundrazi, politikët e saj agresive nuk janë ndalur as një herë të vetme, madje veç sa janë acaruar. Të gjithë duhet ta dinë se taksa është masa më e vogël politike që ka mundur dhe që e ka marrë Qeveria e Kosovës ndaj Serbisë së Vuçiqit.

Kushdo që e ka përcjellë vizitën e Putinit në Serbi këto ditë duhet që ta kuptojë se Kosova është kafshatë e vogël për ta shkëputur Serbinë nga kthetrat e Ruisisë së Madhe. Të gjithë e dimë se në Konferencën e Londrës (1013), Kosova i që shkëputur padrejtësisht Shqipërisë, për t'i kënaqur apetitet e Ruisisë cariste dhe për t'i ikur një luftë në shkallë botërore, por luftës as Evropa e as Bota nuk iu shmangën dot. Kosova që sakrifikuar kot së koti. Ndërsa popujt e botës përjetuan një luftë të madhe botërore. Edhe tani, kot lodhen

politikantët e mjerë të Kosovës, e më kot lodhen miqtë nga ShBA-ja e BE-ja se Serbinë nuk mund ta shkëpusin dot nga vargoit e hekurt të Ruisisë së Putinit.

Ndoshta "arroganca" e treguar ndaj mikut, një ditë edhe ka mundësi të kuptohet e mirëkuptohet, por nënshtrimi për interesa a frikë personale, për cilindo "gabim" të djeshëm, nuk mund ta justifikojë përluljen karshi armikut shekullor. Përlulja e ka çmimin e lartë! Askush më mirë sesa ne shqiptarët nuk e dimë këtë. Në një situatë të tillë, për kryeministrin e Kosovës, çdo variant i shkuarjes në zgjedhje është më i mirë sesa heqja eventuale e taksës ndaj Serbisë. Kursi i ri duhet vazhduar!

Një gjë po dihet, çakordimet absurde që po ndodhin këto ditë në të dy shtetet shqiptare (Shqipëri dhe Kosovë), në mes krerëve të lartë të shteteve, janë lajme tepër të këqija! Ky farë kursi duhet që të ndërpritet!

Vendet tona e kombi ynë do të duhej të prisnin harmoni të tjera shtetërore dhe ndër-shtetërore, pa të cilën harmoni, siguria kombëtare është seriozisht e rrezikuar!

Qofsha i gabuar në gjithë këtë që e thashë!

Grekët protestojnë kundër marrëveshjes me Maqedoninë

ATHINË, 20 JANAR - Mijëra protestues u mbledhën të dielën në Sheshin Sintagma të Athinës për të demonstruar kundër marrëveshjes për ndryshimin e emrit të Maqedonisë në Maqedonia e Veriut. Disa protestues u përleshën me policinë deri në shkallët e ndërtesës së parlamentit.

Përleshjet midis protestuesve dhe policisë u shkallëzuan të dielën në një tubim kundër marrëveshjes së emrit të Maqedonisë së Veriut. Ndryshimi i emrit është rezultat i mosmarrëveshjeve në mes të Maqedonisë dhe Greqisë mbi his-

torinë dhe identitetin kombëtar që zgjati 27 vjet. Protesta po organizohet jashtë Parlamentit të Greqisë, i cili pritet të fillojë një debat për ratifikimin e marrëveshjes sot (e hënë) dhe të votojë mbi të deri të premtën.

Protestuesja Natasha Afanasiadou thotë se nuk shihte asnjë mënyrë që të mos shkonte në demonstratë. "Nuk është e drejtë të rrija në shtëpi kur ndodhin gjëra të tilla. Kam një fëmijë dhe nuk dua të shikoj prapa dhe të mendoj se nuk kam protestuar për këtë çështje", tha ajo. "Referendumi do të ishte zgjidhja

më e mirë. Le të vendosin njerëzit. Kjo marrëveshje u miratua pa u kërkuar mendimin njerëzve dhe pa informuar Parlamentin. Kryeministri dhe ministri i Jashtëm vepruan vetë pa pyetur popullin grek", thotë protestuesi Dimitrios Oppas.

Greqia dhe Maqedonia ranë dakord qershorin e kaluar për një marrëveshje që do ta ndryshonte emrin e fqinjit verior të Greqisë në Maqedonia e Veriut. Në këmbim, Greqia do të heqë dorë nga kundërshtimet e saj ndaj vendit që të bashkohet me aleancën e NATO-s.



Fillojnë përgatitjet për zgjedhjet e 2020-s në ShBA

Pritet që një numër i madh politikanësh demokratë të konkurrojnë përballë presidentit Trump i cili vitin e ardhshëm do të garojë për një mandat të dytë, por që për momentin nuk ka ndonjë pretendent mes demokratëve që duket i pozicionuar më mirë për fitore

WASHINGTON, 20 JANAR - Një numër demokratësh ditët e fundit kanë filluar veprimet përgatitore për zgjedhjet presidenciale të 2020-s. Pritet që një numër i madh politikanësh demokratë të konkurrojnë përballë presidentit Trump i cili vitin e ardhshëm do të garojë për një mandat të dytë. Por, për momentin nuk ka ndonjë pretendent mes demokratëve që duket i pozicionuar më mirë për fitore.

Senatorja Elizabeth Warren ishte ndër të parat që filluan përgatitjet për garën elektorale. Ajo shkoi në Ajova dhe Nju Hampshër për takime, dy shtete që zhvillojnë garat e hershme për përzgjedhjen e kandidatëve. "Sot rroga minimale nuk i mundëson një nëne me një fëmijë të jetojë mbi nivelin e varfërisë. Mendojeni pak, për mua ky është debati më i rëndësishëm", tha Warren. Takime me elektoratin ka zhvilluar edhe ish-sekretari i Strehimit, Julian Castro. "Së bashku do të dëshmojmë se shpresa mund ta kapërcejë frikën, se drita është më e fuqishme se errësira dhe se e vërteta është më e madhe se gënjeshtria", tha Castro. Përveç Warren, ka edhe gra të tjera që kanë deklaruar ose

pritet t'i deklarojnë synimet për të hyrë në garë, ndër to senatorja nga Nju Jorku, Kirsten Gillibrand, ligjvënësja nga Havai, Tulsi Gabbard, senatorja nga Kalifornia, Kamala Harris dhe senatorja nga Minesota, Amy Klubuchar. Po ashtu, pritjet që në garë të përfshihen

politikani nga Teksasi, Beto O'Rourke, senatori nga Nju Xhërsi, Cory Booker dhe ish-nënpresidenti Joe Biden, i cili vjet bëri fushatë për kandidatët demokratë për Kongres. "E vetmja gjë që ka fuqinë e nevojshme për ta përçarë Amerikën është vetë Amerika. E kemi parë se kjo ka filluar dhe duhet ta ndalim! Menjëherë!", tha Biden.

Biden mund të jetë më i njohuri mes tyre, por për momentin asnjë nuk duket se gëzon epërsi, thotë analisti Larry Sabato. "Edhe vetë Biden nuk ka ndonjë epërsi të duk-

shme. Ai rezultoi 35-40 % në anketa, pra më dobët se Hillary Clinton, e cila kryesonte në këtë periudhë para zgjedhjeve të 2016-s", tha ai.

Demokratët duhet të përgatiten për një grup të madh konkurrentësh dhe një betejë të gjatë partiake për ta nxjerrë fituesin, thotë analisti Jim Kessler. "Mendoj se gjatë procesit të përzgjedhjes do të bëhet e qartë se ky nuk është proces kurorëzimi, siç ndodhi me Al Gore në vitin 2000, apo me Hillary Clintonin në 2016. Këtë radhë mendoj se procesi

do të jetë shumë i ndezur", tha Kessler.

Presidenti Trump vazhdon të gëzojë popullaritet në mes të republikanëve, megjithëse në shifra më të ulëta se më parë. Por, ka të ngjarë që ai të sfidohet nga ish-gubernatori i Ohajos, John Kasich. "Nëse konkurrojmë, platforma ime do të mbështetet te premtimi për ta ribashkuar vendin", tha ai. Presidenti e ka përqendruar vëmendjen te forcimi i mbështetjes në radhët e bazës së tij. Kjo e bën të vështirë që presidenti të hasë në rivalitet të fortë brenda partisë së vet.



Pas 50 vjetësh rikthehen marrëdhëniet diplomatike Çad - Izrael

Jerusalem, 20 janar - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, njoftoi të dielën rifillimin e marrëdhënieve diplomatike mes vendit të tij dhe Çadit, një vend afrikan me

shumicë myslimane gjatë vizitës së tij në N'Xhamena, ka njoftuar kabineti i tij në Jerusalem. "Netanyahu, që është aktualisht për vizitë në këtë vend dhe presidenti çadian

Idriss Deby Itno, shpallën sot rifillimin e marrëdhënieve diplomatike mes Çadit dhe Izraelit, që janë thyer nga N'Xhamena në vitin 1972", thuhet në këtë komunikatë.

Benjamin Netanyahu u prit në kryeqytetin e Çadit nga ministri i Jashtëm, Mahamat Zene Cherif dhe zyrtarë të tjerë. Më pas ai zhvilloi një takim me presidentin e vendit, Idris Deby.



'Lamtumirë Baca Adem', libër për dhimbjen tonë krenare

Lulëzim ETEMAJ

Më 26 korrik 2018, katër muaj para se të mbusheshin 60 vjet nga burgosja e parë e 19 nëntorit 1958, u shua fizikisht Adem Demaçi. Një pjesë nga dhimbja e madhe në përmasa gjithkombëtare, që shkaktoi shuarja e tij, e nderimit dhe respektit të manifestuar me këtë rast ndaj tij, përkatësisht pjesën e tyre artistike të shkruar, të karakterit ekspresionist, duke qenë se arti është vetë hija jonë, përgjithësisht hija e njeriut, të cilën edhe po deshëm nuk mund ta shmanjim në asnjë kohë dhe rrethanë, Selatin Novosella e ka përzgjedhur me shumë kujdes, dashuri ndaj Bacës Adem dhe shije të hollë dhe të lartë artistike, përmbledhur brenda librit "Lamtumirë Baca Adem", dhe botuar pas kaluar as tre muaj, në fillim të tetorit të vitit të kaluar, nga Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës.

Libri hapet me testamentin e Bacës Adem Demaçi, të titulluar "Idetë nuk vdesin kurrë", për të vazhduar me epitafin e studiuesit të folklorit dr. Zymer U. Neziri, të shkruar në ditën e ndërimit jetë të Demaçit, me titull: "Baca Adem, ti ishe vetë atdheu". Autori i librit, Selatin Novosella, në vijim "Në vend të hyrjes" (f. 11-21), sjell shkrimin e titulluar: "ADEM DEMAÇI VDIQ I QETË", që për bazë e ka thënien shumë kuptimplote të të birit të Bacës Adem Demaçi, Shqiptarit, "baba vdiq i qetë", thënë autorit dhjetë minuta pasi kishte pushuar së rrahuri zemra e madhe e Bacës Adem.

Në këtë shkrim autori, si njohës i rryer i jetës dhe veprës së Demaçit, me një përkushtim të veçantë i ka sjellur 11 shpjegime të argumentuara përse mund të thuhet se Adem Demaçi vdiq i qetë.

E gjithë lënda vijuese e librit është seleksionuar mbi bazën e përafrisë përmbajtësore dhe ndarë në tre krerë. Për dallim të krerëve tjerë, kreu i parë i këtij libri përfshinë tri pjesë kryesore, që mund t'u thuhet edhe nënyserë.

Në pjesën e parë të këtij kreu, të titulluar "Mbledhja komemorativë për vdekjen e Bacës Adem Demaçit", (f. 23-34), autori sjell atmosferën e mbledhjes komemorativë, të karakterizuar nga dhimbja dhe nderimi, të mbajtur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 27 korrik 2018, përmes fjalimeve komemorativë të Kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, të nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Vasilika Hysi, dhe të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi.

Pjesa e dytë e këtij kreu, e titulluar: "Ceremonia shtetërore për varrimin e Bacës Adem", e organizuar në Sheshin "Skënderbe" në Prishtinë të njëjtën ditë, sjell tek lexuesit fjalimet mortore të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, të kryetarit të partisë Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmetit, si dhe fjalimin e të bijës së Bacës Adem, Abetare Demaçit, me

titull "Kisha një baba që e ndava me të gjithë shqiptarët".

Pjesa përmblylëse e këtij kreu (f. 51-55), e titulluar "Ceremonia e varrimit të Bacës Adem Demaçi", përmban fjalën lamtumirëse të autorit të këtij libri, Selatin Novosella, të lexuar në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës në ceremoninë e varrimit në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë.


Dhimbja e madhe për shuarjen fizike të Bacës Adem Demaçi, dashuria për të, mirënjohja, respekti i thellë dhe nderimi për jetën, përkushtimin njerëzor dhe kombëtar, për të gjithë sakrificën e tij jetësore, kjo është shtylla e përbashkët e të gjitha fjalimeve mortore, të mbajtura nga krerë shtetërorë dhe politikë shqiptarë.

Kreu i dytë i librit, i titulluar: "Tubimet - homazhet për Bacën Adem Demaçi" (f. 57-114) përmban të gjithë atë që u tha në tubimet homazhe për Bacën Adem Demaçit, duke filluar me tubimin homazh të mbajtur më 8 gusht 2018 në Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës. Hydajet Hyseni, kryetar i kësaj shoqate, në fjalimin e mbajtur me këtë rast flet për veprën jetësore të simbolit të rezistencës, njëherit prijës të irredentizmit shqiptarë, Bacës Adem Demaçi, të cilën e cilësoi si kurajë dhënëse dhe inspiruese për të gjithë të burgosurit politik shqiptarë, posaçërisht për ata që qëndruan në burgje bashkë me Bacën Adem.

Ashtu si në tubimin e mbajtur nga Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës në Prishtinë, edhe në tubimet tjera, që mbahen nga Shoqëria Kulturore Artistike "Agimi" në Prizren, më 2 shtator 2018, në Tiranë nga Federata Universale e Paqes - Këshilli Shqiptar i Paqes, më 21 shtator 2018, nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, më 21 shtator në Prishtinë, në fjalimet që u mbajtën nga përfaqësuesit e tyre, njëherit edhe bashkëveprimtarë dhe bashkëmendimtarë të Bacës Adem si Meriman Braha, Ali Lajçi dhe Abdyl Kadolli, u lartësua gjithashtu figura emblematike e Bacës Adem. Detajet dhe këndvështrimet e ndryshme të këtyre fjalimeve hedhin më shumë dritë si në veprën jetësore, atdhetare ashtu dhe atë letrare të Bacës Adem. Kreu përmbillet me filmin dokumentar, "I pathyeshmi - Adem Demaçi", të regjisorit Valon Bajrami, prodhim i RTK-së.

Ky film përfshinë periudhën kohore nga viti 1970 deri në vitin 1990, ku përmes rrëfimeve të të bashkëburgosurve në Stara Gradishkë hidhet dritë shtesë mbi figurën e Bacës Adem, të cilën e karakterizon qëndresa dhe stoicizmi. Dokumentari, siç thotë autori, Valon Bajrami, ishte pararenduar t'i bëhet befasi Bacës Adem Demaçi, por ja që kalimi i tij në amshim ua kishte pamundësuar këtë.

"Shkrime të veçanta, telegrame dhe pershlypje në 'Librin e Zisë', me rastin e vdekjes së Bacës Adem Demaçit", këshuto e ka titulluar autori Selatin Novosella kreuin e tretë (f. 115-325), të fundit, njëherit më të vëllimshmin, të librit. Kreun e hap shkri-



mi i akademik Rexhep Qosjes me titull: "Mandati i tij, mandat i gjithëkohshëm", si cili pasohet nga shkrimi "Filozofia dhe etika politike e Adem Demaçit", të profesorit dhe diplomatit Sabri Kijçmari dhe shkrimi i publicistit Blerim Shala me titull "Adem Demaçi dhe ne".

Nga akademik Rexhep Qosja, Baca Adem me këtë rast cilësohet si mandatar i gjithëkohshëm në historinë e popullit tonë si mësues historik, politik, kulturor, kombëtar e moral i rinisë shqiptare në Kosovë, të cilës si askush tjetër ia mësoi qëndrimin e drejtë, të papërkulshëm, të dinjitetshëm, që nuk e përkulnin leverditë, premtimet, kërcënimet, burgjet. Sabri Kijçmari, frymën politike të krijuar nga Baca Adem e cilëson si frymë të orientuar drejt tri ideve themelore: idesë së kombit, lirisë dhe barazisë. Ndërkaq mbështetjen e luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe përfaqësimin e saj e sheh si një rrjedhje logjike të filozofisë politike të Bacës Adem Demaçi.

Në shkrimin e tij "Adem Demaçi dhe ne", Blerim Shala trajton kompleksitetin e figurës së heroit Adem Demaçi për të arritur gjer tek konkludimi i thukët: Liria e të gjithë neve, dhe shtet i Kosovës, nuk kanë si të paramendohen pa të.

Në pjesën përmblylëse të këtij kreu janë përmbledhur 21 telegramet e personalitetëve të ndryshme, shtetërore, politike, të artit dhe kulturës, duke filluar nga Sali Berisha, Jakup Krasniqi, Ismail e Helena Kadare, Azem Syla, Bajram Kosumi, Edi Rama, Isa Mustafa, Fatmir Limaj, general Kudusi Lama, Xhavit Haliti, Albin Kurti, Myftiu Naim Tërnava, Imzot Dodë Gjergji, Lulzim Basha, Agim Vinca, Pandeli Majko, Bedri Islami, Shaip Beqiri, Izmi Zeqa, Sonja Biserko dhe Latinka Peroviç.

Pjesa e fundit e këtij kreu përmbledh 861 pershlypje të qytetarëve të shkruara në "Librin e Zisë". Ky numër sado që në dukje i madh, nuk është e gjitha, por vetëm një pjesë e pershlypjeve. Zgjedhja e fjalëve, dhembja, emocionit, mirënjohja e shprehur dhe vlerësimi i lartë i jetës dhe veprës së Bacës Adem, kjo është ajo që i karakterizon këto pershlypje.

Sipas fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe, emri Bacë është një emër, me të cilin në disa krahina të Shqipërisë Veriore vëllai i vogël thërret vëllanë e madh ose femijet thërtrasin babanë a xhaxhanë...

Për ta shprehur vlerësimin e lartë dhe

respektin ndaj jetës dhe veprës së tij në shërbim të Kombit, të drejtave njerëzore dhe kombëtare të bashkëkombësve si dhe përgjithësisht vlerave universale të njerëzimit, me emrin Bacë, edhe në këtë libër, Adem Demaçi është thirrur 916 herë. Duke qenë se libri në përgjithësi i ka 328 faqe, i bie mesatarisht 3 herë për çdo faqe libri. Janë 714 të nënshkruar të "Librin e Zisë" që Adem Demaçit i janë drejtuar me thirrjen Bacë. Me emrin Bacë, Adem Demaçit i drejtohen edhe drejtues të institucioneve të shtetit të Shqipërisë dhe Kosovës, ish-themelues dhe drejtues të UÇK-së, lider politikë, personalitete të kulturës dhe të artit nga bota akademike etj., si presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, Azem Syla, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Jakup Krasniqi, Hydajet Hyseni, Fatmir Limaj, gjenerali Kudusi Lama, akademik Rexhep Qosja, profesor Agim Vinca, Isa Mustafa, Marjan Demaj, Myftiu Naim Tërnava dhe kuptohet, pashmangshëm, edhe vetë autori i librit, Selatin Novosella.

Për të vënë në pah veçantinë e tij në çdo aspekt, Baca Adem Demaçi është i vetmi personalitet publik në Kosovë të cilit qytetarët shqiptarë, jo vetëm në Kosovë, por nga të gjitha vendet e banuara me shqiptarë, i referohen masovikisht me një epitete të tillë nderues.

Hero, ky është emri tjetër, titulli, epitete dominante në libër, me të cilin personalitete dhe qytetarë të ndryshëm i janë referuar Bacës Adem Demaçi. 121 herë e quajnë hero Bacën Adem bashkëveprimtarë të ndryshëm, bashkëqendruer në burgje, qytetarë të rëndomtë, të të gjitha moshave, gjinive dhe kategorive shoqërore, politikanë e liderë institucionalë e politikë të Shqipërisë, të Kosovës, Maqedonisë dhe nga e gjithë hapësira shqiptare. Krahas presidentit Ilir Meta, kryekuvendarit Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj, Nënkryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi, kryekuvendarit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, Kryetarit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, Hydajet Hyseni, janë edhe 79 bashkëkombës të tjerë, të nënshkruar në "Librin e Zisë", të cilët Adem Demaçin e konsiderojnë hero.

Prijës, frymëzues, kolos, humanist, janë vlerësimet e tjera të shumta për Bacën Adem që i hasim në libër. Në funksion të përfundimit të këtij recensionit, do të kthehem edhe një herë në fillim të librit, konkretisht tek 11 motivet e sjella nga autori pse mund të thuhet se Baca Adem vdiq i qetë. E shoh me interes të posaçëm t'i vechoj dy prej tyre; atë në pikën 2 dhe tjetër në pikën 6, për faktin e lidhshmërisë së fuqishme mes vete, përkatësisht përmbushjes së të dytës nga e gjashta.

Përderisa nën pikën dy autori e sjell si argument formimin në shtator të vitit 1963 të organizatës së njohur irredentiste Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSh), me të cilën Baca Adem do të shndërrohej në bartës dhe njëkohësisht prijës shpirtëror të irreden-

tizmës shqiptare, në Nenin 1 të Statutit të cilës thuhet, se "Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara me shumicë prej shqiptarëve të cilët gjenden ende nën administrimin e Jugosllavisë, d.m.th. qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është çlirimi i krahinave shqiptare, të aneksuara prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet - Shqipërinë", kurse nën Nenin 2 të këtij Statuti thuhet se "Lëvizja jonë, për ta mbërritur qëllimin e lartpërmendur, ka me përdorë të gjitha mënyrat dhe mjetet që i vijnë përdore - prej atyne politiko-propagandistike - mjete paqësore, e deri të lufta e armatosur dhe kryengritja e përgjithshme popullore - mjete jopaqësore, në pikën 6, pas 35 vjetëve të kaluar nga koha e themelimit të Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSh), e gjejmë Demaçin një vitin 1998 në funksionin e përfaqësuesit të përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës së saj të armatosur, e cila me çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës pa asnjë dilemë që ka hapë perspektiva të reja, realiste, të realizmit të tërësishtëm të qëllimit programor të Lëvizjes së formuar nga Baca Adem Demaçi.

Autori Selatin Novosella, bazuar në krijimtarinë e tij voluminoze të karakterit shkencor si dhe të atij publicistik kushtuar Bacës Adem Demaçi, nuk është vetëm njëri nga bashkëmendimtarët dhe bashkëveprimtarët që për 55 vjet ishte pa shkëputur pranë tij, por ai është edhe jetëshkruesi më i përkushtuar dhe më i njohur i veprës dhe jetës së Bacës Adem.

Në librin e tij të fundit "Lamtumirë Baca Adem", që po e promovojmë sot, autori ka sjellë për lexuesit me një kujdes për t'u admiruar, me kreativitet dhe originalitet, të gjithë atmosferën, emocionet e shkaktuara nga dhimbja jonë gjithëkombëtare - dhimbja jonë krenare, të gjithë atë që u tha nga ata që u përfshinë në këtë libër me ato çfarë shkruan e me të gjithë atë që e thanë me rastin e ndarjes fizike nga Baca Adem.

Autori Selatin Novosella përmes kësaj përmbledhjeje monografike ka dhënë një kontribut të veçantë për historiografinë shqiptare, duke u ofruar studiuesit të këtij lëmi një libër të domosdoshëm për t'u referuar gjatë hulumtimeve të reja si të karakterit shkencor historik, po ashtu edhe të atij politik, sociologjik e kulturor.

E përgëzoh nga zemra për këtë libër të ri kushtuar Bacës Adem, Bacën tonë që e fitoi përjetësinë ngaqë, krahas të gjitha angazhimeve të tjerë të pareshura dhe të pashoqe si në rrafshin politik, kulturor e human, u bë bartës kreu i veçantë dhe, njëkohësisht, edhe simbol i përkushtimit këmbëngulës që, siç është thënë bukur në testamentin e shkruar prej tij, njerëzit të mësohen të shkojnë prapa ideve, të mos shkojnë vetëm prapa njerëzve, sepse njerëzit mund të burgosen, mund të sëmuren, mund të vdesin, kurse idetë nuk vdesin kurrë!

E rrallë

Pinguinët përfundojnë në polici

Dy pinguinë ishin rrëmbyer në kopshtin zoologjik në nëntor të vitit të kaluar. Pas një hulumtimi prej dy muajsh, hetuesit arritën t'i zbulojnë dhe t'i gjejnë pinguinët një fshat në perëndim të Nottinghamit në Britani. Një 23-vjeçar nga Preston i është dyshuar si autor i grabitjes.



FOTO E DITES



Në Capitol Hill në Uashington D. C. janë mbaruar tre dordolecë. /AP/

E jashtëzakonshme

Shtëpi për një euro në Itali

Sambuca është një qytet i bukur në ishullin e Sicilisë në jug të Italisë, por zhvendosja drejt e metropolit e ka lënë këtë qytet thujse të pabanuar, e për këtë arsye kryetari i bashkisë së zonës ka vendosur që shtëpitë e pabanuara t'i shesë për një euro. Vetëm pak orë pas publikimit të lajmit, kanë qenë mbi 38 mijë kërkesa



që kanë ardhur në adresën zyrtare, shumë më tepër sesa shtëpitë që ndodhen në këtë zonë.

BARSOLETA E DITËS



Pyet djali babanë polic:
- Babi, sa dhëmbë ka goja?
- 36.
- Jo more babi, se mësuesja na tha se dhëmbë të përhershëm janë 32.
- Po, se i ngatërrova me shkronjat e alfabetit.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“THE GRINCH” 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

“THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS” 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

“MORTAL ENGINES” 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

“HUNTER KILLER”,

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Keni marrë disa vendime që ju kanë vënë në mendime sot. Mbase nuk ishte mënyra e duhur ajo që zgjodhët për t'i bërë publike.



DEMI

Sot do t'ju anulohen të gjitha planet që keni bërë për ditën si pasojë e një çështje që do të dalë papritur dhe kërkon zgjidhje emergjente.



BINJAKËT

Mbase keni shpresuar më tepër sesa që duhet në disa ngjarje që nuk kanë ndodhur ende. Beni një bilanc të ditës tuaj dhe ndryshoni qëndrim.



GAFORRJA

Mos lejoni që sot të neglizhohet një projekt i caktuar që ka afatet e veta. Nëse ndodh kjo gjë të gjitha pasojat do të bien mbi ju.



LUANI

Ka disa mundësi sot për të dalë nga një situatë e bezdisshme që po ju shqetëson. E rëndësishme është të zgjidhni atë që bie më pak në sy.



VI RGJËR ESHA

Nuk ka pse t'ju kapë paniku për gjëra që nuk janë verifikuar ende. I keni të gjitha mënyrat për ta sqaruar pozicionin tuaj.



PESHORJA

Nëse nuk doni të përshkoni shumë rrugë sot për të arritur në përfundimet e kërkuara, duhet t'i besoni intuitës suaj që ju ka zgjidhur gjithmonë punë.



AKREPI

Sot doni të jeni sa më pranë personave që punojnë me ju. Mbase duhet të kuptoni dhe nevojat e tyre dhe të mos tregoheni egoist.



SHIGJETARI

Po përçoni stres te personat afër jush sepse dhe ju vetë në këto çaste jeni shumë të ngarkuar. Ruani qetësinë dhe kërkon mbështetje.



BRICJAPI

Nëse nuk keni arritur të zgjidhni një problem familjar, sot duhet t'i kushtoni të gjithë kohën e nevojshme. Edhe familja ka kërkesat e veta.



UJORI

Meqë tani jeni në lojë duhet të filloni të ecni sipas rregullave të lojës. Prisi kohën tuaj dhe veproni me maturi për të qenë sa më të sigurt.



PESHQIT

Nëse nuk doni t'ju kritikojnë sot, duhet patjetër të sqaroni një situatë të ndërlikuar që ka prekur jo pak njerëz. Ju keni gjeneruar gjithçka.

Kylie dhe Travis shijojnë në maksimum pushimet



Ylli televiziv Kylie Jenner dhe i dashuri saj Travis Scott kanë shkuar për pushime në ishullin britanik Turks dhe Caicos. Sipas "Hollywood Life", ata janë

disa ditë me radhë aty. Çifti si duket po e shijon në maksimum këtë pushim pasi gjatë kohës sa janë atje janë duke publikuar vazhdimisht fotografi në rrjete sociale.

Jennifer Lopez poston fotografi pa make up



Këngëtarja 49-vjeçare Jennifer Lopez ka postuar në "Instagram" një fotografi selfie pa grim. Në një intervistë të fundit ajo ka dhënë për media se ka dy

fëmijë të mahnitshëm dhe një të dashur të mrekullueshëm. Këngëtarja është duke shijuar jetën me të dashurin, ish-sportistin Alex Rodrigues.



Brad Pitti harron Angelina Jolien, kapet 'mat' me bionden seksi në Hollywood

Aktori i njohur hollivudian Brad Pitt duket se e ka harruar përfundimisht ish-bashkëshorten Angelina Jolie pasi është duke dalë me një tjetër yll, që ka dominuar për shumë kohë listën e bukurosheve të kinematografisë. Raportimet për një

romancë të re të Pittit vijnë dy vjet pas ndarjes nga Jolie, teksa në "greqin" e aktorit 55-vjeçar ka rënë biondja seksi Charlize Theron, tashmë 43 vjeçe. "The Sun" raporton se ata u prezantuan nga ish i fejuari i saj Sean Penn.



Bella Hadidi me veshje sportive shihet rrugëve të Nju Jorkut

Javën që lamë pas Bella Hadidi kaloi natën duke festuar ditëlindjen e një shoku të saj në një ndejë në Nju Jork. Një ditë pas, ajo doli me një veshje shumë sportive në Nju Jork. 22-vjeçarja që shpesh komentohet për stilin e

saj në përditshmëri edhe këtë herë mori vëmendjen e paparacëve. Ajo kishte të veshur një xhakëtë tepër të gjerë dhe disa atlete neoni. Në fotografitë e shkrepura në rrugë, Bella shihet e buzëqeshur dhe e lumtur.

Ataturku, historia e një burri të pashëm



Mustafa Qemal Ataturku, më pas Qemal Ataturku, ishte një ushtar-shtetar i jashtëzakonshëm, i gjysmës së parë të shekullit të XX-të. Ai dallonte nga diktatorët e periudhës në të cilën jetoi në dy aspekte domethënëse: në politikën brenda vendit dhe themelimin e një sistemi politik që arriti t'i mbijetonte kohërave. Në frymën e këtij shpirti realist ai rigjeneroi vendin e tij, duke e shndërruar Perandorinë e vjetër e të shkatërruar Otomane në një republikë të re dhe të njësuar. Ataturku nuk ishte një turk i zakonshëm.

Kishte lëkurë shumë më të çelët nga bashkëkombësit e tij, me mollëza të kërcyera dhe sy blu të mëdhenj. Ishte truppakët dhe i matur në lëvizje. Rrezatonte energji, madje edhe kur ishte në prehje; sytë e ftohtë i shndrisnin me gjallëri të pazakontë dhe përçonin dritën e gjendjeve të

tija kontradiktore. Herë ishte shumë shprehës e herë fjalë-pakë.

Herë tensioni i brendshëm i dilte fuqishëm së jashtmi, përmes një shpërthimi të ashpër e herë qetësohej, duke i dhënë fytyrës një pamje sharmante e të përpunuar qytetare. I dhënë pas pamjes së tij të jashtme, vishej në mënyrë të stërholluar, lakonte vetullat në mënyrë të vetëdijshme, krenohej për gjymtyrët e tij të mirëformuara, të cilat parapëlqente që t'ua paraqiste miqve të tij të afërt me shkakun e futjes në pishinën që e kishte ndërtuar në kopshtin e shtëpisë. Nuk i parapëlqente brohoritjet popullore, por i duheshin për detyrën që i kishte vënë vetes. I përçmonte, por edhe mashtrohej prej tyre.

Kur në një rast një shok i propozoi që të bënte një veprim përshëndetës para njerëzve, ai iu përgjigj me përbuzje duke ia

pritur: "Unë nuk veproj për opinionin publik. Veproj për kombin dhe për kënaqësinë time personale". Të dy motivet ishin të sakta. Për aq sa Ataturku ishte i aftë që të donte, ai e donte vendin e tij.

Ambicia, e nxitur fuqishëm nga imagjinata, nga një natyrë zotëruese si dhe një vullnet i pamposhtur, ishte për pushtetin, por për një pushtet që donte t'ia jepte popullit, sipas mënyrës së tij, sipas asaj çka kishte vendosur në mendjen e tij se ishte më e mirë për ta. Kishte një mendje që nuk pushonte kurrë, të mbrujtur me parimet e civilizimit perëndimor që ndikuan liberalët turq që në shekullin e XIX-të. Kishte një mendje që thithte në mënyrë të vazhdueshme idetë e të tjerëve, të cilat i përpunonte dhe i shiste si të tija, por gjithmonë bazuar në praktikë, duke mos i besuar shumë teorive. Në metodë ishte

pragmatist.

Mundohej të bënte zap mungesën e durimit për të bërë përpara, "hap pas hapi drejt objektivit të synuar". Megjithatë, hapat ishin të shpejtë. Qëllimet liberale shpesh arriheshin përmes mjeteve jo liberale, përmes trajtimeve të pamëshirshme të miqve dhe armiqve bashkë. Edhe pse ndonjëherë tregohej i pandjeshëm ndaj jetës së njerëzve, Ataturku, personalisht nuk ishte çnjerëzor. Ai e njihhte dhe e çmonte qënien njerëzore, individualisht, apo në masë, duke ia vlerësuar karakterin dhe parashikuar veprimet përmes intuitës.

Në trajtimin e njerëzve ishte shumë i luhatshtëm. E dinte se kur duhet t'i bindte, kur t'i miklonte, kur duheshin kërcënimet, kur duhet të komandonte dhe mbi të gjitha, ishte mjeshhtë i finesës politike. Shpesh kishte prirje gazmore dhe i shijonte

shoqëria me njerëzit, madje qeverinë e tij e mblidhte në tryezën e darkës. Parapëlqente që me një zë rezonant e të pastër, i krahasuar me atë të një versioni mashkullor të Sarah Bernhardt, të fliste gjithmonë hapur, shpesh pa pushim, me nënkuptime e mënçuri sarkastike e me kthesa të menjëhershme të frazës.

Dikur për Kryeministrin e vet, Ismet Inonu, pati thënë: "Rreth belit të tij rrotullohen 50 dhelpra, por asnjëra syresh nuk kap dot as bishtin e tjetrës". Ataturku e transformonte jetën rreth tij. Ai shijonte dhe u përgjigjej hapur admirimit të grave. Në klimën e ndryshimit që pasoi vdekjen dhe pasimin e tij në pushtet nga konvencionali Inonu, një admiruese e Ataturkut tha: "Turqia ka humbur dashnorin e saj dhe më në fund duhet të mbledhë mendjen të gjejë një bashkëshort". Ishte një ndjesi me të cilën shumë turq ishin dakord. /Gazeta Shqip/

Koreja e Veriut, metodat e regjimit për të shmangur arratisjen e diplomatëve

Kush dëshiron t'i kthejë shpinën regjimit, duhet të përgatisë pikërisht rrugën e shpëtimit. Pa lënë dyshime, duke shmangur tri unazat e ndërhuara nga fuqia e Phenianit: kontrollet, ndëshkimin, fushatën e denigrimit kundër arratisjes.

Ata që duan t'i kthejnë shpinën regjimit të Koresë së Veriut, duhet të përgatisin rrugën e largimit në një mënyrë të saktë. Pa lënë dyshime, duke shmangur tri unazat e ndërhuara nga pushteti për të mbajtur diplomatët e tij në

gjirin e tyre. Një pajisje e bërë edhe më e ashpër nga Marshalli Kim Jong un, i bindur se është kreu që të gjithë e duan, por i vetëdijshëm për "dobësitë" e "subjekteve" të tij. Të shumtë janë ata që duan të ikin nëse gjejnë mundësi më të mira. Dhe kështu bëri Jong Sol-gil.

Kontrollet

Unaza e parë përfaqësohet nga kontrollet. Të ngushtë, të ngulët. Përfaqësuesit jashtë vendit mbikëqyren nga kolegët e tyre dhe, në disa raste, nga agjentë të dërguar në ambasada të ndjeshme. Ata janë hijet e hijes. Gjatë dy viteve të fundit, Pheniani do të kishte rritur vëmendjen në staf: zyrtarët u rivendosën në përfaqësitë, ndërkohë që autoritetet kanë nxitur hakmarrje kundër "llumit" (kështu që quhen transfugat). Lajmi i spastrimeve dhe shtënavë – ndonjëherë ngritur pa kontrolle shumë, është sërish e

vështirë – mund të shërbehet si një paralajmërim i mëtejshëm. Nëse ikën, rrezikon vetë dhe njerëzit e tu të afërm.

Dënimi

Unaza e dytë është ndëshkimi. Ka pasur episode ku shërbimet kanë eliminuar (ose janë përpjekur ta bëjnë) kundërshtarët që kanë ikur jashtë vendit. Në vitin 2011 doli se spiunët e Marshallit përdorën age helmuese dhe teknika të tjera për të mbyllur gojë të internuarve. Seul zbuloi gjithashtu se regjimi kishte përdorur një transfugal si një agjent të dyfishtë: ai ishte dorëzuar, por kishte filluar misionin e tij të vërtetë. Misioni ishte për të vrarë një koreane të Veriut që kishte braktisur, duke shkuar në Jug. Veprimet klandestine ndodhën gjithashtu në Kinë, të cilat parashikuan vrasjen e Kim Jong nam, gjysmë vëllai i udhëheqësit, të helmuar me një kimik në Kuala Lumpur. Krimi i

pabesueshëm vetëm për të kujtuar se çfarë është çmimi i zgjedhjes së anës së gabuar. Zbulimet e fundit mbi një ndërhyrje të hakerëve në Korenë e Jugut, një operacion që na ka lejuar të marrim duart në një listë të gjatë të arratisurish, jo vetëm që përfaqëson një shkelje të rëndë, por tingëllon si një mesazh i rëndë për ata që kanë shkuar "nga pjesë tjetër".

Fyerja

Elementi i tretë është fushata e denigrimit kundër të arratisurve. Mediat zyrtare përdorin ofendimet, përhapin informacione të rreme për objektivin, e përshkruajnë si të korruptuar. Në të kaluarën ky aktivitet shërbeu si një tabelë e tymit për lëvizje më të forta, veçanërisht kundër atyre që thyen me nomenklaturën dhe mbetën në vende ku ishte e mundur që Veriu të dërgonte një grup rrëmbyesish. U takonte atyre të rrëmbejnë

objektivin për ta sjellë atë në atdheun e tyre, ku ishte duke pritur skuadra e qitjes.

Të metat

Sistemi, megjithëse i egër, ka mbajtur pjesërisht. Ngjarjet e diplomacisë së Londrës në vitin 2016 dhe tani ajo e Jong Sol-Gil, janë "pikat kyçe" që bëjnë lajme sepse skenari është Europa, me intriga të inteligjencës, rol të paqartë dhe pjesëmarrjen e shumë aktorëve. SHBA-të, koreano-veriorët, aparatet tona. Së bashku me këto histori ka edhe të tjerë, më pak të habitshëm, të cilët megjithatë e turbullojnë fuqinë e udhëheqësit të madh. Ne mund t'i quanim ata të shpëtuar nga liria, të kryera nga oficerë, ushtarë të thjeshtë dhe nganjëherë peshkatarë. Para tyre hapet një rrugë dhe ata e marrin atë me shumë të panjohur, sepse ata nuk e dinë se çfarë do të vijë më pas. (gazeta-Shqip.com)





Autor: GAZMEND MORINA	ATDHETARI NË FOTO	KËNGËTARJA TOSKA	▼	NJERI QË MERRET ME NJË ZANAT A MJESHTERI THEMBRA E KËPUCËS	KARROÇË E HAPUR ME KATËR RROTA, E TËRHEQUR PREJ KUAJSH	RENS ISTVUD	ZANORE	EPOKA ERE	DÌCKA E MËRZITSHME, NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË	HUMBAS NJOMËSINË, FORCËN, GJALLËRINË DHE SHËNDETIN	FLORIRI
	DEGË E NJOMË, E GJATË, E HOLLË DHE E DREJTË, FILIZ (shq.)							ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER POEZIA E DASHURISË			
	PLAKU ME PËRVOJË, QË MERREJ SI GJYQATAR NË NJË ÇËSHTJE						FUTBOLLISTI ARGJENTINAS BANEGA (VALENCIA) AKUZUES I SOKRATIT				
	VENDLINDJA E ODISEUT					KËNGËTARJA LUAR LIBËR FILLESTAR					
	GJOJS		BIMË E VENDEVE TË NXEHTA (shq.) FUTBOLLISTI FRANCEZ DIARRA								ARKEOLUG YNË SKËNDER
	SHËNIM NË FUTBOLL			EMËR MASHKULLI MYSLIMAN GROSS TONNAGE REGISTER					TONI ADAMS SËPATË E VOGËL		
	U SPËRKAT ME UJË				HIDROKARBUR I PANGOPUR E MPAKUR						
	MUNDËSI, SHANS (sh.shq.)						THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI TATUAZH (bised.)				
EPOKA ERE	MËSIM PRAKTIK OSE TEORIK	FUSHËBETEJA	FUTBOLLISTI LIONEL	INDIUM	"... TAK"	ARMENIA	USHTRI (sh.shq.) ZANORE				BASHKËT. HUQI, VESI
	KONFERENCË NDËRKOMBËTARE NË RANG PRESIDENT-ËSH					TRUP GJEOMETRIK PORTOFOLI	EPOKË (shq.) VLERËSIM ME NOTË		GURRA FILM I AKTORIT BEN AFFLECK		
	LUMË NË KOSOVË					SONDAZHI KLUB FUTBOLLI NË SPANJË				ALUMIN VARG MALESH TË LARTA (sh.shq.)	
	PIKË A VEND NË QENDËR TË DIÇKAJE			BASKETBOLLISTI YNË ERMAL KOHË		DY ZANORE		NJË PLANET E BËRA COPE- COPE NJË LETËR			
▶				DRU PYLLI I LARTË ATË		NUMËR THEMELOR BANORET E NJË SHTETI SKANDINAV		GIRLS LEADERSHIP INSTITUTE SHTEGU			LLOJ REVOLJEJE
	BËRJE MË I RI NYNBERG, AUGSBURG		ORDER BRITISH EMPIRE BURRË SHTETI (shq.)			SHOUMENI KRASTA		VRIMË E MADHE DHE E THELLË (sh.shq.) PEMË E VENDEVE TROPIKALE			
	ZANORE	TRUP I NJERIT NGA KOKA DERI TE KËMBËT SHKENCA MBI PAQEN				LLOJ SHALE DRURI KLUB FUTBOLLI NË ITALI			ZANORE SMALT	TOTENHAM AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR	
	CEREMONI FETARE		QEN I MURRMË, MURRASH FORTESE				BEREQETI				PREVA DEGËT E TEPËRTA TË NJË PEME
EPOKA ERE	ANALISTI POLITIK BLERIM FJALA E DHËNË PËR DIÇKA					OKSIGJEN, NEON SHTËPI PLEQSH (shq.)	LUFTËTARI VOKSHI OLIVIA MUNN		DY BASHKËTINGËLLORE QYTETI ITALIAN I MODËS		
	AKTORJA UELLSIANE CATHERINE JONES			FEMRA LUFTËTARE (mit. greke) I FILLOVA				HYJNI E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE PJATA			
▶						SOLISTJA ... BYTYQI VEPËR E KRIMINELIT		PARIA E SHOQËRISË MBAJTJE E ANËS			
	KRYEVEPRA E LEONARDO DA VINÇIT DESPOTIZËM					KASTRIOT TUSHA PËREMËR PRONOR	KLUB FUTBOLLI NË ARGJENTINË "... LORENZO" KËNGË E POPULLARIZUAR		"LISERA" TEDI ALVES		
	DY (turq.)		MUZIKANTI BAJRI DY ZANORE				BASHKËT. LËRE (bised.)	PJESA E ERRËT E DITËS BREJTËS I VOGËL			ZANORE ANNA RUSO
	MIMOZA AHMETI		SHKOMBËTARIZIMI DYRRAHU					RROGË VJETORE E PAPËS INDIA			
	IRLANDA	KUNDREJT URREJ				PËRHAPJA E VALËVE			NJËSI KOHE		

Historia e dashurisë së Tina Turner

Ajo ishte një dashuri me një shikim. Tina Turner do të shprehej kështu e pyetur mbi lidhjen e saj me Erwin Bach, gjermanin me të cilin tashmë po kalon jetën. I gjatë, i veshur gjithnjë elegant, Erwin ka arritur të kapë vëmendjen e mediave dhe për përkushtimin që ka ndaj së shoqes. Diferenca e moshës nuk e ka fashitur pasionin mes tyre. Ata u takuan për herë të parë në një festë pas çmimeve EMI në vitin 1985. Vetëm një vit më pas, ata do të lidheshin me njëri tjetrin. Tina e kujton si jo të lehtë këtë raport.

Por ishte muzika ajo që i bënte bashkë. Ai dinte ta shihte ndryshe nga të tjerët atë që kalonte brenda saj teksa këndonte. Erwin dinte të shihte muzikën brenda saj, ndoshta se e shihte me sytë e dashurisë. Në korrik të vitit 2013-të ata u martuan, pas gati 27 vitesh që ishin bashkë. Ata zgjodhën liqenin e Zyrhiut për festën e madhe ku kishin ftuar miqtë më të mirë. Kjo ishte martesë më e bukur që mund të mendonte këngëtarja e

cila mbante veshur një fustan mëndafshi. Vetëm disa ditë pas martesës çifti organizoi një tjetër parti të madh ku ambienti ishte zbukuruar më 70.000 trëndafila të kuq dhe të verdhë. Midis 120 miqve të pranishëm ishin të ftuar dhe Eros Ramazoti, Giorgio Armani, David Bowie, Oprah Winfrey.

Erwin Bach është një emër i njohur në industrinë muzikore. Disa nga artistët e mëdhenj ia dedikojnë suksesin pikërisht atij. Pink Floyd, Paul McCartney, Pet Shop Boys, apo vetë bashkëshortja e tij Tina Turner ia dedikojnë suksesin pikërisht Erwin. Në librin autobiografik Tina tregon se sa shumë e kishte ndryshuar dashuria për të.

Tashmë që këngëtarja ka kaluar kohë jo të mira me shëndetin, ka pranë vetëm Erwin, i cili kohë më parë dhuroi dhe një veshkë për të. Askush nuk të shpëton përveç dashurisë, shprehet Tina në libër, teksa u thotë lexuesve se ka gjithnjë kohë për dashuri në jetë, duke marrë si shembull zhgënjimin nga martesë e saj e parë.



Shtëpia, 5 këshilla të dobishme për ta mbajtur të ngrohtë



Kufizimi i shpërndarjes së nxehtësisë gjatë sezonit të dimrit është i mundur: ja se si të veproni

Folenë tonë gjithmonë e duam të ngrohtë dhe mikpritëse, por ndonjëherë, përkundër radiatorëve të nxehtë, në shtëpi nuk jemi aq rahat, sepse temperaturat është e vështirë të rriten. Ndonjëherë, për fat të keq, ajri i ftohtë depërton shumë lehtë brenda shtëpisë dhe pengon ngrohjen e prodhuar brenda nga radiatorët, zjarri ose sobat. Megjithatë, ne mund ta përmirësojmë situatën, ja se si.

Zgjidhni kohën e duhur: Për të bërë punët e shtëpisë ose për të ndryshuar ajrin në dhoma, ne evitojmë hapjen e dritareve herët në mëngjes, kur temperatura është pothuajse akullnajore. Në vend të kësaj, le t'i japim ajër shtëpisë në orët qendrore të ditës, për shembull në pushimin e drekës, kur rrezet e diellit janë më të ngrohta dhe ndikimi në

temperaturat e brendshme bëhet i pranueshëm. Shumë dritë dhe pak ngrohtësi janë një ilaç i shkëlqyeshëm kundër grisë së dimrit.

Radiatorët në krye: Le t'i lëmë të lirë radiatorët. Shmangni vendosjen e rrobave (të cilat nuk thahen kurrë) duke varrosur radiatorët me çorape, të brendshme dhe rroba të varura: në qoftë se i vendosim, e zvogëlojmë në masë të madhe kapacitetin termik: rrobat do të jenë të thata, por ne do jemi të mpirë!

Luani me dritaret: Drita e diellit ngroh, kështu që gjatë ditës hapim rilat në maksimum për ta mbajtur shtëpinë të ngrohtë. Në mbrëmje, megjithatë, kur temperatura bie, ne i ulim dhe mbyllim gjithçka: një truk i vogël që do të na ndihmojë për të ruajtur një temperaturë të pranueshme

brenda shtëpisë. Më shumë se 20% e humbjes së ngrohjes në shtëpi u atribuohen hapjes së dritareve dhe dyerve: po të kemi mundësi, idealja do të ishte investimi në efikasitetin energjetik të shtëpisë, vendosjen e instalimeve të reja, izolimin adekuat të mureve me veshje dhe mbulesat e jashtme dhe, nëse është e nevojshme, zëvendësimin e bojlerit të

vjetër me një efikasitet të lartë, ndoshta duke përfutur nga stimujt.

Mbyllni dyert: Madje edhe brenda mureve të shtëpisë, ne mund të përdorim disa truke të tjera: për shembull, duke mbyllur dyert e brendshme të dhomave për të ngadalësuar humbjen e nxehtësisë dhe për të krijuar një barrierë natyrore midis nesh dhe të fto-

htit. Nëse na pret një mbrëmje në divan në dhomën e ndenjes, të mbështjellë dhe nga përkëdheljet dhe një film i mirë në televizion, ne mbajmë mbyllur dyert e dhomave të tjera: ndryshimi i temperaturës do të jetë i prekshëm.

PUTHITJA E DRITAREVE: Siç bënim gjithëherë, me një qiri të ndezur pranë kornizave të dritareve mund ta kuptoni nëse jeni në prani të një të çare. Për ta eliminuar atë, përdorni vetëm guarnicionet prej gome, shumë të lehta për t'u aplikuar në të çara dhe që mund të gjenden në treg pa problem. Ne gjithashtu përdorim ngjitëse shtesë: ka shumë ngjyra dhe modele, ato janë efektive dhe i japin gëzim mjedisit. Lidhur me dyshemenë, nëse është shumë e ftohtë ne përdorim tapetat: të bukur dhe elegante, ata japin ndjenjë e ngrohtësisë dhe kontaktit. Janë pa diskutim më të ngrohtë se mermeri dhe pllaka, si dhe kontrastojnë shpërndarjen e nxehtësisë nëpër dysheme.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

EIBAR - ESPANYOL

GG3+

GENOA - AC MILAN

2

LE HAVRE - RED STAR

1

Hajdari: Më bindi projekti i Gjilanit

Futbollisti që ka hyrë në historinë e futbollit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, Fiton Hajdari, është ndarë me skuadrën e Llapit dhe është bërë pjesë e Gjilanit. "Jam i lumtur që jam pjesë e Gjilanit. Ofertën e tij e pranova pa asnjë hezitim kur e pashë projektin e klubit që ka ambicie serioze për edicionin e ardhshëm. Siç dihet, Gjilani është një klub shumë serioz dhe ka tifozë shumë të mirë, prandaj është kënaqësi për mua se do t'i mbrojë ngjyrat e këtij klubi", ka thënë Hajdari



EPOKA E HËNË Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 JANAR - Sulmuesi anësor Fiton Hajdari është larguar nga skuadra e Llapit dhe është prezantuar në skuadrën e Gjilanit. 27-vjeçari gjatë verës e kishte braktisur skuadrën e Trepçës '89 për t'u rikthyer në klubin e vendlindjes se tij, por në këtë afat kalimtar ai vendosi të largohet. Hajdari e braktisi Llapin që është në garë për titull për t'u bashkuar Gjilanit që është jashtë garës për titull dhe Kupë. Hajdari të dielën për "Epokën e re" ka treguar se projekti i klubit nga Anamorava e ka bindur për t'u

bashkuar në këtë afat kalimtar. "Jam i lumtur që jam pjesë e Gjilanit. Ofertën e tij e pranova pa asnjë hezitim kur e pashë projektin e klubit që ka ambicie serioze për edicionin e ardhshëm. Siç dihet, Gjilani është një klub shumë serioz dhe ka tifozë shumë të mirë, prandaj është kënaqësi për mua se do t'i mbrojë ngjyrat e këtij klubi", ka thënë Hajdari. Sulmuesi që shkroi historinë duke u bërë lojtar i parë nga Kosova që realizon gol në garat e Ligës së Kampionëve ka treguar se ngjyrat e Gjilanit do t'i mbrojë deri në qershor të vitit të ardhshëm. "Kontratë kam nënshkruar deri në qershor të vitit

2021. Do të mendojem maksimalisht që të kontribuojë në sukseset e kësaj skuadre", ka shtuar Hajdari, i cili dy vjet më parë dha një kontribut të madh në rrugëtimin e Trepçës '89 drejt titullit kampion. Gjilani, përveç Hajdarit, nga skuadra e Llapit e ka transferuar edhe mesfushorin Kushtrim Shabani, i cili përfaqëson klubin gjilanas ka deklaruar: "Gjilani është një klub mjaft serioz dhe ka ambicie të mëdha me një projekt fantastik, prandaj nuk ishte e vështirë ta bëja zgjedhjen time, se ku ta vazhdoj karrierën. Falënderoj edhe tifozët për mikpritjen. Shpresoj që së bashku të fitojmë shumë 'beteja'".

SHKURT

'89-shi aranzhon dy miqësore në Durrës

Trepça '89 vazhdimin e përgatitjeve për sezonin pranveror do ta bëjë në Durrës. Skuadra nga Mitrovica ka mbërritur të dielën në Durrës, kurse atje kjo skuadër do të zhvillojë edhe dy ndeshje miqësore. Ish-kampionia e Kosovës do të luajë miqësore me skuadrën e Besës së Kavajës dhe Vëllaznimin nga Gjakova. '89-shi e ka mbyllur stinorin vjeshtor në vendin e shtatë me 22 pikë të grumbulluara pas 17 ndeshjeve.

Vonni: Kjo ishte gara e fundit e karrierës sime

Skiatorja amerikane Lindsey Vonn, ikona e garave në dëborë, ka deklaruar pak më parë se gara e zhvilluar në pistën italiane të Cortinas, ajo e super-gjigantit, mund të jetë gara e saj e fundit në karrierë. Vonn, 82 fitore në garat e Kupës së Botës, nuk arriti ta përfundojë këtë garë të zhvilluar për shkak të një përplasje me një "portë". "Mendoj se kjo ka qenë gara ime e fundit. Nuk di se çfarë mund të bëj tjetër, pasi dhimbja është shumë e fortë. Nuk doja që ta mbyllja në këtë mënyrë", ka thënë Vonn. Këtë sezon skiatorja amerikane synonte ta arrinte rekordin e 86 fitoreve të suedezit Ingemar Stenmark, por duket se ky objektivi nuk do të realizohet nga skiatorja 34-vjeçare.

Ronaldo i dëshiron Marcelon dhe Iscon te Juventus

Cristiano Ronaldo, pas transferimit në Torino, kërkon që të tërheqë me vete dy lojtarë, që tek Reali nuk po shkojnë shumë mirë me trajnerin Solari. Ata janë Marcelo dhe Isco, të cilët janë fiksuar në stol nga tekniku spanjoll dhe nuk po e gjejnë veten te "Los Blancos". Miqësia e Ronaldos me Marcelon është e madhe dhe duket se është dhe e pandashme. Ata lidhen shumë mirë në fushën e lojës dhe jo vetëm. Kështu që Ronaldo ka shtuar kontaktet me brazilianin dhe kërkon ta tërheqë me vete në Torino. Marcelo është vërhëlyer nga tifozët në golin e parë të pësuar nga ekipi i tij dhe duket se nuk ndien më siç ka ndjerë për atë fanellë. Nga ana tjetër edhe Isco nuk po kalon një moment të mirë te Reali dhe kërkon që të lëvizë nga Madridi. Ronaldo me spanjollin kanë një marrëdhënie të mirë dhe skuadra e Juventusit intrigon lojtarin, pasi ka shumë vje në organikë.

Shkëndija transferon futbollistin me vlerë një milion euro

Shkëndija e Tetovës nuk di të ndalet këtë afat kalimtar dhe vazhdon të afrojë në skuadër lojtarë shumë cilësorë. Pas ardhjes së sulmuesit Ibrahim, Shkëndija ka bërë një tjetër goditje "big". Bëhet fjalë për mesfushorin me nënshtetësi kroate, Zeni Husmani. 28-vjeçari është një lojtar shumë cilësor dhe, sipas "Transfermarkt", vlera e tij më e madhe ka kapur një milion euro në vitin 2011. Mesfushori difensiv është një vlerë e shtuar e kuqezinjve nga Tetova, që duket se titullin kampion të Maqedonisë e kanë siguruar, por synojnë të ecim sa më shumë edhe në arenën evropiane.

Përfaqësuesja në basketboll grumbullohet më 18 shkurt

PRISHTINË, 20 JANAR - Përfaqësuesja A e Kosovës në basketboll do të grumbullohet më 18 shkurt në Prishtinë për ndeshjen kundër Rumanisë që u takon parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Dueli Kosovë - Rumani do të zhvillohet më 24 shkurt 2019 me fillim nga ora 20:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Kosova bën gara në Grupin B dhe në tri duet e para ka pësuar dis-

fata, dy herë nga Maqedonia dhe një herë nga Rumania, ndërsa e ka edhe një shans në muajin gusht për ta siguruar një vend për në kualifikime për "Eurobasket 2021". Pra, Maqedonia i prin grupit me 6 pikë, ku nga tri ndeshje ka po aq fitore, kurse Rumania dhe Kosova i kanë nga tri pikë secila, përderisa rumunët i kanë luajtur dy ndeshje deri më tani dhe dy të

tjerat do t'i luajnë në muajin shkurt, së pari kundër Maqedonisë, më pas kundër Kosovës. Fituesi i grupit do ta sigurojë një vend për në kualifikime për "Eurobasket 2021". Raundi shtesë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht, ndërsa emrat e kundërshtarëve Kosova do t'i mësojë në shkurt pas ndeshjes kundër Rumanisë.



Elba Kokaj dhe Klea Vrella përgatiten për "Sarajeva 2019"

PRISHTINË, 20 JANAR - Skitaret e ekipit Olimpik të Kosovës, Elba Kokaj dhe Klea Vrella, po përgatiten në qendrën skitare në Brod të Dragashit, para pjesëmarrjes në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror (EYOF) që mbahet prej 9-16 shkurt 2019

në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Kokaj (17-vjeçare) dhe Vrella (16) do të garojnë në disiplinat sllallom dhe sllallom i madh. Përgatitjet skitareve u janë mundësuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës,

sikurse përgatitjet jashtë vendit të mbajtura javë më parë në Erzurum të Turqisë. "Jemi të vendosur në Brod prej dy ditësh dhe do të qëndrojmë edhe disa ditë. Kushtet janë të mira dhe përgatitjet janë të mirëseardhura për përfaqësimin sa më të mirë

në EYOF", deklaroi trajneri Feim Kollçaku për "noc-kosovo.org". Me skitaret në Brod ndodhet edhe trajneri tjetër Egzon Agani. Kosova është në mesin e 48 shteteve të Evropës që do të marrë pjesë në EYOF Sarajeva & Sarajeva Lindore



2019. Për herë të parë në EYOF-in dimëror, KOK-u u paraqiti në "Erzurum 2017".

Goli i sjell vetëbesim Milot Rashicës

BREMEN, 20 JANAR - Milot Rashica ia fitoi ndeshjen Werder Bremenit kundër Hannoverit. Goli i tij nuk ishte spektakolar, por tejet i rëndësishëm për Bremenin dhe për vetë anëtorin nga Kosova. Në një intervistë pas ndeshjes, Rashica shpjegoi se si i ka tejkaluar vuajtjet pas formës jo të mirë në fillimin e tij në Bundesligë. "Nga njëherë shënon nga 30 metra largësi, e nganjëherë del huq nga dhjetë metra afërsi. Unë thjesht tentoj t'i harroj ato raste [të humbura] dhe të përqendrohem në detyrat e ardhshme", ka thënë Rashica në 11 ndeshje deri tani në Bundesligë ka shënuar tri gola dhe ka bërë një asistim. Sido që të jetë, Rashica është në prag ta zërë një vend titullar në formacionin bazë të Werderit. Florian Kainz është larguar nga klubi dhe për më tepër, shpejtësia e kosovarit është pothuajse e domosdoshme në lojën e Werderit. Siç e ka shpjeguar



edhe trajneri Florian Kohfeldt së fundmi, ndihma që vushtriasi i ofron skuadrës duke u kthyer mbrapa po përmirësohet çdoherë e më shumë. Mund të shihet qartë se Rashica po bëhet lojtar i kompletuar i Bundesligës. "Për mua ka qenë shumë e vështirë kur erdha në

Werder, ishte një dallim i madh [me ligën holandeze]. Jam shumë i lumtur. Këto pikë janë shumë të rëndësishme për ne. Goli do të më japë vetëbesim. Unë e di se mundësitë vijnë nëse punon fort. Shanset më kanë ardhur", ka deklaruar 22-vjeçari.

Houstoni ndali lakersat, Toronto e Buckso bëjnë ligjin në Lindje



HOUSTON, 20 JANAR - Skuadra e Torontos nuk ndalet në rrugëtimin e saj në Konferencën e Lindjes, pas fitores 119-90 ndaj Memphisit, sukcesi i 35-të sezonal për kanadezët, ekipi me më shumë fitore. Takim i dominuar nga basketbollistët kanadezë, me Greenin që realizoi 24 pikë. Kanadezët rivalizojnë në krye me Milwaukee që, gjithashtu, ka dalë fituese nga ndeshjet e sotme, duke mundur 118-108 Orlando jashtë fushës. I zakonshmi Antetokounmpo ishte lider për Bucksin, autor i 25 pikëve e 13 reboundeve, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Bledsoe me 30 pikë. Në

Perëndim, skuadra e Houstonit mposhti Lakersin 138-135 pas kohës shtesë, një ndeshje spektakolare dhe me shumë emocione. Miqtë dominua në ndeshje shumicën e kohës (Kuzma 32 pikë), por në fund

REZULTATET

Philadelphia - Oklahoma	115-117
Charlotte - Phoenix	135-115
Detroit - Sacramento	101-103
Indiana - Dallas	111-99
Orlando - Milwaukee	108-118
Atlanta - Boston	105-113
Toronto - Memphis	119-90
Chicago - Miami	103-117
Houston - Lakers	138-134
Denver - Cleveland	124-102

erdhi përmbysja e Rocketsit, me Hardenin që realizoi 48 pikë, më i miri në fushë, raporton "Telesport". Fiton edhe skuadra e Denverit, rivalja më e afërt e Golden States në Perëndim. Skuadra e Nuggetsit mundi 124-102 Clevelandin, një formalitet për Denverin, ku gjashtë lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Jokiçi realizoi një "triple double", 19 pikë 11 rebounde e 12 asistime). Pa problem fiton Miami, që mposhti 117-103 Chicagon, sfidë e vendosur në periodën e fundit për skuadrën nga Florida. Për Miamin u dalluan Richardsoni me 26 pikë dhe Waitersi me 21.

SHKURT

Modriqi: Dua të qëndroj gjatë në Real

Luka Modriqi në një prononcim për "AS" foli për të ardhmen e vet. 33-vjeçari largon zërat e largimit, me Interin që nuk heq dorë nga ëndrra për ta ofruar në "San Siro" dhe tregon dëshirën e tij për të qëndruar gjatë në Madrid. "Kam dhe një vit e gjysmë kontratë me Realin dhe ndihem i qetë, pasi ka akoma kohë. Jam i lumtur, ashtu siç isha ditën e parë këtu. Kam vetëm një dëshirë dhe dua të qëndroj gjatë këtu ku jam", ka thënë Modriqi.

Tsitsipas eliminon Federerin nga "Australian Open"

Synimi i Roger Federerit për ta kompletuar "hat-trickun" me titujt të "Australian Open" ka marrë fund sot pasi ka humbur nga greku Stefanos Tsitsipas, raporton "Reuters". Talenti grek arriti çerekfinalen e tij të parë në një "Grand Slam". 20 vjeçari e mposhti Federerin me rezultat prej 6-7(11) 7-6(3) 7-5 7-6(5). Në çerekfinale Tsitsipas do të përballlet me spanjollin Roberto Bautista Agut, i cili eliminoi Marin Cilicin.

Reus: Nuk do të shkoj kurrë në Bayern

Borussia Dortmund i ka parë shumë lojtarë të talentuar teksa vijnë dhe shkojnë në vitet e fundit, por Marco Reus këmbëngul se nuk do të jetë një prej atyre që e braktis klubin. Veçanërisht e dhimbshme për tifozët e Dortmundit ka qenë largimi i shumë yjeve në drejtim të rivalit Bayern Munchen. "Nuk do të më shihni duke luajtur në Bayern, ju premtoj. Po ashtu, jam gati 30-vjeçar dhe ata duan ta rinojnë skuadrën e tyre", ka thënë Reus.

Morata, afër rikthimit në Spanjë

Alvaro Morata gjithmonë e më larg Chelseas. Efekti i largimit të Gonzalo Higuainit nga Milani drejt bluve të Londrës do të sjellë një efekt "domino" në merkato. Spanjoli, sipas asaj që raporton "COPE", ka firmosur për Atletico Madridin. Marrëveshja është arritur për një huazim me të drejtë blerjeje në fundin e sezonit. Kujtojmë se Morata ka luajtur për Realin e Madridit dhe tashmë shkon te rivalët e kryeqytetit. Diego Simeone do të jetë ai që do të kërkojë ta "ringjallë" 26-vjeçarin, që nuk ka treguar rendiment që pas largimit nga Juventus.

Eliminohen Sharapova dhe Kerberi

Dita e shtatë e "Australian Open" ka dhuruar disa surpriza, dy nga të cilat ndodhën në kategorinë e femrave. Maria Sharapova dhe Angelique Kerber i thanë lamtumirë përpara kohe turneut të parë "Grand Slam" të vitit, pasi u eliminuan në fazën e 1/8-ave të finaleve. Tenistja ruse Sharapova u eliminua nga Ashlei Barty me australianen që fitoi 2-1. Sharapova e nisi më mirë sfidën teksa fitoi setin e parë 6-4, por Barty iu kundërpërgjigj ish-numrit një të botës, duke fituar dy setet e tjerë 6-1 dhe 6-4. Edhe më keq shkuan gjërat për numrin dy të botës, Angelique Kerber, që u eliminua nga debutuesja Danielle Collins. Tenistja amerikane ishte e papërmbajtshme ndaj Kerberit dhe e dominoi totalisht ndeshjen, të cilën e mbylli brenda 56 minutave, duke e fituar 2-0 me sete 6-0 dhe 6-2.

Mourinho thumbon Pochettinon

Tottenhami është pa trofe që nga viti 2008 dhe Mauricio Pochettino ende nuk ka fituar asnjë trofe të rëndësishëm gjatë karrierës së tij si trajner. Jose Mourinho Mourinho mendon se Pochettino do të ndryshojë qasjen e tij, kur ai të fillojë dhe të fitojë disa tituj. "Ai mendon ndryshe nga unë. Ai mendon ndryshe, apo ndoshta ditën kur të fillojë të fitojë trofe, ai do ta ndryshojë komunikimin. E pëlqej shumë atë si person dhe si trajner. Nuk po e kritikoj atë", ka thënë Mourinho.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



20 Janari kujtim i thellë në zemrat tona



AFRIM (SINAN) HAJRIZI

(01.02.1965 - 20.01.1999)

Si sot ky 20 janar ashtu qe 20 vite jetojmë me mallin për ty. Pavarësisht kohës malli e dhembja për ty nuk u shua asnjëherë por vazhdon të mbetet përherë në zemrat tona.
Me mall të përkujtojnë: Nena: Zyla, vëllezërit Zeneli, Hysniu me bashkëshorte Lutfijen, motrat Rrushja, Xheva, Myrveti, Xhezidja, djemtë Remziu, Kastrioti si dhe Afrimin i cili mban emrin e Axhës se vetë, vajzat Valentina, Florentina, Drenusha me bashkëshortët si dhe nusët Vlora dhe Kosovarja si dhe nipat e mbesat.

Njëzet vite pa më të dashurin tonë



AFRIM (SINAN) HAJRIZI

(01.02.1965 - 20.01.1999)

Njëzet janari i vitit 1999, është një ditë shumë e veçantë për ne dhe për të gjithë kombin tonë. E përkujtojmë djalin, vëllain e prindin tonë të ndjerë Afrim Hajrizi i cili dha jetën e tij që ne, ta gëzojmë lirinë ku e jetojmë edhe sot.
Më mall të pashuar e kujtojnë: nëna Zyla, vëllai Zeneli, djali Artani, Qemali, Keqa, Gazmendi dhe Labinoti si dhe mbesat dhe nipërit që jetojnë në diaspora.

Dje me 20 janar shënuam 20-vjetorin e ndarjes tënde



AFRIM (SINAN) HAJRIZI

(01.02.1965 - 20.01.1999)

Me rastin e 20 vjetorit të ndarjes fizike të kujtojmë me mallëngjim e krenari.
 Do të kujtojmë çdoherë të tillë se çfarë ishte i dashur, i afërt, zemërgjerë, njeri që sakrifikove gjithçka për ne.
 Vdekja të mori nga ne por jo edhe nga zemrat tona.
 Kujtimi që kemi për ty nuk do të shuhet asnjëherë.
Me mall të kujtojmë: nena Zyla, Xhemilja; vajzat Qendresa, Ergjenia, Blinera, dhëndurët: Besarti, Emiri, Dardani, nipi Donarti, mbesat: Amra dhe Demara.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ahmet (Avdulla) Selmani shpallë të pavlefshme dëftesat e vitit të I dhe të II, të shkollës së mesme Teknike Prishtinë.
- ▶ "Vorego" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 930016502.
- ▶ N.N.T. "Dekorativ" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 601045166 me pronar Naser Halimi, Vushtrri.
- ▶ Naser Asllani shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc.
- ▶ Mufail Hoxha shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc
- ▶ Musa Kuliqi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc
- ▶ Urgjentisht kërkoj një lokal me qira për Fast Food. Hapësira deri 70m2. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 045/660-188
- ▶ Unë Fahri Avdiu distancohem nga djali im Bledi Fahri Avdiu dhe nuk marr asnjë përgjegjësi dhe asnjë obligim për veprat e tija, si borgje, vjedhje apo marrje të parasë me fajde. Si dhe njëkohësisht kërkoj nga ju të dëmtuarit që mos të më kontaktoni as në telefonin tim. Me respekt Fahri Avdiu.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz të banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

